


Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.9/10, Shtator - Tetor 2014

AUDIENCA E PAPA FRANÇESKUT I KUSHTOHET UDHËTIMIT NË SHQIPËRI

Vatikan 24.09.2014

“Përshëndesim këtë popull të guximshëm që kërkon bashkimin”

Audienca e Papa Françesku i kushtohet Udhëtimit Apostolik në Shqipëri me 21 shtator 2014, në fjalën e tij e të botuar në faqen zyrtare të Radio Vatikanit ai kërkon që të përshëndetet populli shqiptar si një popull i guximshëm, punëtor, që në paqe, kërkon bashkimin.

Papa Francesku gjatë audiencës së ditës së mërkure ka folur për udhëtimin e të dielës në Shqipëri. Ai ka theksuar, se ky është një akt falënderimi ndaj Zotit, që i mundësoi këtë Vizitë, për të treguar afërsinë tij, e të gjithë Kishës me popullin shqiptar. Më pas Ati Shenjte ka përsëritur mirënjohjen për Ipeshkvijtë shqiptarë, meshtarët, e rregulltarët që punojnë me impenjim. Papa Francesku ka shpjeguar edhe njëherë arsyen që e nxiti të vizitojë Shqipërinë, si ndalesa e pare në Evropë. -“Kjo vizitë lindi nga dëshira për të shkuar në një vend, që, pasi u shtyp për një kohë të gjatë nga një regjim ateist e çnjerëzor, po përjeton përvojën e bashkëjetesës paqësore ndërmjet feve. M’u duk shumë e rëndësishme ta inkurajoj në këtë udhë, që ta vazhdojë me këmbëngulje e të

thellohet në të gjitha aspektet, për të mirën e përbashkët. Pashe me kënaqësi të thellë, se bashkëjetesa paqësore dhe e frytshme ndërmjet njerëzve e bashkësive, me fe të ndryshme, jo vetëm është e dëshirueshme, por dhe e mundur dhe e zbatueshme në praktikë. Ata e praktikojnë!”. Duke përshkuar rrugët kryesore të Tiranës, Papa u shpreh, se mundi të shihte portretet e 40 meshtarëve të vrarë, gjatë diktaturës komuniste, për të cilët ka nisur procesi i lumnit. Këta u shtohen qindra njerëzve të fesë, të krishterë e myslimanë, të vrarë, torturuar e internuar, vetëm sepse besonin në Zotin. Vërtet, sot, Shqipëria është shembull, jo vetëm për rilindjen e Kishës, por edhe për bashkëjetesën paqësore ndërmjet feve,- vazhdon Papa në fjalën e tij. Vëllezërve e motrave të Shqipërisë, u përsëris ftesën për të pasur guximin drejt të mirës, për të ndërtuar të tashmen e të ardhmen në vendin e tyre e në Evropë. Do të doja, që të gjithë ne, ta përshëndesim këtë popull të guximshëm, punëtor, që në paqe, kërkon bashkimin-përfundon Papa Francesku fjalën për udhëtimin në Shqipëri.





Radio Vatikani GJONI XXIII E PALI II JANË SHENJTORË	4
Redaksia PAPA GJON PALI II	6
Don Lushi Gjergji PAPA GJONI XXIII	8
Radio Vatikani PAPA FRANÇESKU BASHKON NË LUTJE	13
Don Nosh Gjollaj FAKTORËT QË SHKATËRROJNË FAMILJEN	16
Dom Nikë Ukgjini KISHA KATOLIKE DHE SFIDAT	20
Redaksia MENTOR QUKU - JETA DHE VEPRA	24
Frano Kulli LAMTUMIRE MJEDOLOGUT	25
Begzad Baliu STUDIUESI QË NGRITI MONUMENTIN	26
Redaksia DEKORIMI I PROF. MENTOR QUKUT	29
Mentor Quku LETRA PËRSHËNDETËSE	30
Kronisti TITULLI PROFESOR NDERI	31
VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 5/6 (464-465) Maj - Qershor 2014

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Atë Mario Imperatori S.I.
Dom Gjovalin Sukaj
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Papa Françesku: “Karol Wojtila vazhdon të na frymëzojë me dëshminë e jashtëzakonshme të shenjtërisë së tij”!

Na frymëzojnë fjalët, shkrimet, gjestet, mënyra e tij e shërbimit. Na frymëzon vuajtja e tij, jetuar me shpresë heroike. Na frymëzon lëshimi i tij i plotë në duart e Krishtit, Shëlbuesit të njeriut, dhe në ato të Nënës së Zotit”.

I jam mirënjohës Polonisë për Gjon Palin II. Kështu pohon Papa Françesku në një video mesazh, transmetuar nga televizioni e radioja kombëtare polake, me rastin e shenjtërimit të Karol Wojtilës e të Anxhelo Ronkalit (Gjoni XXIII), të dielën, më 27 prill. Ati i Shenjtë vë në dukje “dëshminë e jashtëzakonshme të shenjtërisë” së Papës polak, duke i ftuar të gjithë të frymëzohen nga shembulli i tij. Jam i lumtur që po e shpall shenjtor Karol Wojtilën, njeri e Papë i madh, nënvizon Françesku në mesazh: “I jam mirënjohës Gjon Palit II, ashtu si të gjithë anëtarët e Popullit të Zotit, për shërbimin e tij të palodhur, për udhëheqjen e tij shpirtërore, për faktin se e ka çuar Kishën në udhën e mijëvjeçarit të tretë të fesë e për dëshminë e jashtëzakonshme të shenjtërisë”

Më pas, Papa Bergolio kujton homelinë e Benediktit XVI në ditën e lumnimit të Karol Wojtilës. Gjon Pali II i pati kërkuar gjithë botës të mos ketë frikë e t’ia hapë portat Krishtit. Ai vetë, i pari, bëri ç’është e mundur për t’ia hapur Krishtit portat e shoqërisë, të kulturës dhe të sistemeve politike e ekonomike, duke kontribuar, me forcën e një gjiganti, në ndryshimin e kahes së historisë, e cila dukej e pakthyeshme: “Me dëshminë e tij të fesë, të dashurisë e me guximin apostolik, shoqëruar me një ngarkesë të madhe humane, ky bir shembullor i kombit polak i ndihmoi të krishterët e gjithë botës të mos kenë frikë ta quajnë veten ndjekës të Krishtit, të bëjnë pjesë në Kishë, të flasin për Ungjillin. Me një fjalë: na ndihmoi të mos kemi frikë nga e vërteta, sepse e vërteta është garanci e lirisë. (Homelia, 1 maj 2011). Identifikohem plotësisht me këto fjalë”.

Papa Françesku kujton edhe se Karol Wojtila është formuar si i krishterë, në Poloni. Aty është formuar zemra e tij, që më pas, mori përmasa universale, së pari, duke marrë pjesë në Konkilin II të Vatikanit, e pastaj, pas 16 tetorit 1978, si Papë, duke bërë ç’është e mundur që në këtë zemër të gjenin vend të gjitha kombet, gjuhët e kulturat: “Gjon Pali II u bë gjithçka për të gjithë. Falënderoj popullin polak dhe Kishën në Poloni për dhuratën e Gjon Palit II. Të gjithë jemi pasuruar nga kjo dhuratë. Gjon Pali II vazhdon të na frymëzojë. Na frymëzojnë fjalët, shkrimet, gjestet,

mënyra e tij e shërbimit. Na frymëzon vuajtja e tij, jetuar me shpresë heroike. Na frymëzon lëshimi i tij i plotë në duart e Krishtit, Shëlbuesit të njeriut, dhe në ato të Nënës së Zotit”.

Gjatë vizitës së fundit “ad limina Apostolorum” të ipeshkvijve polakë, thotë në fund të mesazhit Papa Françesku, nënvizova se Kisha në Poloni vazhdon të ketë mundësi të mëdha feje, lutjeje, bamirësie e dashurie të krishterë. Shenjtërimi i Gjon Palit II dhe i Gjonit XXIII, uroi Ati i Shenjtë, qoftë nxitje për punën e kësaj Kise, të cilën Françesku do ta njohë më nga



afër me rastin e Ditës Botërore të Rinisë, që do të mbahet në Krakov, në vitin 2016. E i kthehet së dielës së shenjtërimit: “Shumë prej jush do të vinë në Romë, por falë mass media-ve, shumë të tjerë mund të marrin pjesë në këtë ngjarje të madhe. Prandaj, dua t’i falënderoj që sot, të gjithë gazetarët e shtypit, të radios e të televizionit për shërbimin e tyre me rastin e shenjtërimeve të 27 prillit. Përsëritës të gjithë bashkëkombësit e Gjon Palit II, edhe ata, që nuk i përkasin Kishës Katolike. I kam të gjithë në zemër. Zoti ju bekoftë të gjithëve!”

Zgjedhja e Karol Wojtilës në fronin e Shën Pjetrit. Dje, e lamë jetën e Papës Gjon Pali II në qershor të vitit 1978, kur populli polak ishte përfshirë nga protestat kundër komunizmit, që kardinali Wojtila i mbështeste me mish e shpirt. Pas pak javësh – informon gazetari italian Gian Franco Svidercoschi në librin-intervistë me kardinalin Stanislao Xhivish, “Kam jetuar me një shenjt”, të cilin po e shfletojmë së bashku këto ditë, para shenjtërimit të Papës polak – vdiq Pali VI. E 33 ditë pas zgjedhjes, më 29 shtator, ndërroi jetë pa pritje edhe Gjon Pali I. Wojtila, si të gjithë kardinalët, u kthye në Romë. “Shihej qartë, gjatë udhëtimit – thotë kardinali Xhivish, ish-sekretari personal i tij – se kishte diçka që e shqetësonte. Kësaj radhe, ishte më shumë i mbyllur në vetvete, në mendime, në lutje. Ishte e ditur se në Konklavin e mëparshëm kishte pasur një sërë votash për emrin e tij. ... Por ai nuk thoshte asgjë. E natyrisht, unë nuk e pyesja”.

PAPA FRANÇESKU: FEJA, LIDHJE DASHURIE E BESIMI NË ZOTIN

*Audienca dhe Lutjet e Engjëllit të Tenzot.
Vatikan, 24. 08. 2014.*

Kisha, populli i Hyjit, ka me Hyjin lidhje dashurie e besimi. Kështu u shpreh Papa Françesku në lutjen e sotme të Engjëllit të Tenzot, duke shpjeguar se Jezusi deshi një Kishë, që nuk themelohej më mbi prejardhjen, por mbi fenë. E Françesku e përshkroi figurën e bashkësisë kishtare në ndërtim, si një ngrehinë. Pastaj përshëndeti Ukrainën, në ditën e festës kombëtare, shoqëruar me thirrjen drejtuar popullsisë në një situatë tensioni e konflikti, të cilit nuk po i duket fundi. “Lidhja jonë me Krishtin, ndërton Kishën”. Kështu u shpreh Papa Françesku, duke nënvizuar se Zoti e ka në mendje figurën e asaj, që do të ndërtojë, figurën e bashkësisë, si ndërtesë. Kështu Papa, që në vijim kujtoi se Jezusi, kur dëgjoi dëshmimin e qartë të fesë nga goja e Simonit, e quajti “shkëmb”. Shprehu edhe dëshirën që ta ndërtonte Kishën pikërisht mbi fenë e tij. Simoni Apostull e dëshmoi besimin e tij në Jezusin si Krisht, Bir i Hyjit të gjallë. Për fenë e tij, nënvizoi Papa, e jo për meritat, Jezusi i tha: “Ti je Pjetër, shkëmb, e mbi këtë shkëmb do ta ndërtoj Kishën time”. Duke komentuar Ungjillin e së dielës, Françesku nënvizoi: “Të ndalemi një çast pikërisht mbi këtë pikë, mbi faktin se Jezusi i jep Simonit këtë emër të ri 'Pjetër', që në gjuhën e Jezusit tingëllon 'Kefë', fjalë që do të thotë 'shkëmb'. Në Bibël

kjo fjalë lidhet me Hyjin. Jezusi e quan kështu Simonin jo për cilësitë e meritat e tij njerëzore, por për fenë e tij të vërtetë e të patundur, që i vjen nga lart”. Françesku pohoi se Jezusi ndjen në zemër një gëzim të madh, sepse shikon në Simonin, dorën e Atit, hirin e Shpirtit Shenjt. Shikon se Hyji Atë i dha Simonit një fe të besueshme, mbi të cilën Ai, Jezusi, do të mund ta ndërtonte Kishën e Tij, domethënë, bashkësinë: “Jezusi dëshiron t'i japë jetë Kishës 'së Tij', një popull, që nuk bazohet mbi prejardhjen, por mbi fenë, domethënë, mbi lidhjen me atë vetë. Lidhje dashurie e besimi. E për ta nisur Kishën e vet, Jezusi ka nevojë të gjejë në zemrën e dishepujve një fe të patundur, 'të besueshme'. Pikërisht këtë duhet të verifikojë në këtëpikë të udhës”. “Po sot? Për çka ka nevojë Jezusi?”: “Vëllezër e motra, ajo që i ndodhi në mënyrë të pashoqe Shën Pjetrit, i ndodh edhe çdo të krishteri, që fiton pjekurinë në një fe të sinqertë në Jezu Krishtin, Birin e Hyjit të gjallë. Ungjilli i sotëm na drejtohet edhe ne të gjithëve. Nëse Zoti gjen në zemrën tonë një fe, nuk po them të përkryer, por të sinqertë, të vërtetë, atëherë Ai shikon edhe në ne gurët e gjallë, me të cilët mund të ndërtojë bashkësinë e tij, domethënë, ne të gjithë. Të gjithë ne”. E Françesku shtoi, jashtë teksti, duke iu drejtuar besimtarëve të





pranishëm: “Si shkon feja jote? Secili ta japë përgjigjen në zemër të vet, eh? Si shkon feja jote? Si është? Çfarë gjen Zoti në zemrat tona: e kemi zemrën të fortë, si guri, apo si rëra, domethënë, besëpakë, dyshimtare, të lëkundur? Do të na bëjë mirë sot ta mendojmë këtë”. Në këtë bashkësi, nënvizoi Françesku, guri i themelit është Krishti, gur këndi, i vetmi. Pastaj është Pjetri, për të cilin Papa Françesku kujtoi: “Pjetri është shkëmb, sepse themel i dukshëm i unitetit të Kishës”. Më pas Papa iu drejtua gjithë të pagëzuarve: “Por gjithë të pagëzuarit janë të thirrur t’ia ofrojnë Jezusit fenë e tyre, të varfër, por të sinqertë, që Ai të mund të vijojë ta ndërtojë Kishën e tij, sot, në

të katër anët e botës”. Edhe në ditët tona, pohoi Papa, njerëzit mendojnë se Jezusi është profet i madh, mësues i dijes, model i drejtësisë. E edhe sot Jezusi vijon t’i pyesë dishepujt e vet: “Po ju, kush thoni se jam unë?”. Prej këndeje, pyetja e Papës: “S’përgjigje do t’i japim? Ta mendojmë. Por sidomos, ta lusim Hyjin Atë që të na e japë përgjigjen. Me ndërmjetësimin e ‘Krishtit, Birit të Hyjit të gjallë!’”. Papa nënvizoi rëndësinë e dëshimit të fesë, duke u kërkuar të gjithëve ta përsërisin bashkë me të, tri herë. Pas lutjes mariane, mendimi i Papës shkoi në Ukrainën e dashur: “Tek të gjithë bijtë e bijat e saj, tek dëshirat e tyre për paqe e qetësi, kërcënuar nga një situatë tensioni e konflikti, që nuk do të paqësohet, duke shkaktuar shumë vuajtje në gjirin e popullsisë civile. T’ia besojmë Zotit Jezus e Zojës së Bekuar mbarë Kombin e të lutemi së bashku, posaçërisht për viktimat, familjet e tyre e të gjithë ata që vuajnë”. Papa Françesku pohoi se ka marrë një letër nga njëri prej ipeshkvijve të Ukrainës, që flet shumë për dhimbjen e thellë të njerëzve në këtë vend të munduar. Pastaj, një mori përshëndetjesh, drejtuar grupeve të ndryshme, besimtarëve e shtegtarëve të pranishëm në Sheshin e Shën Pjetrit, nën një qiell, që të kujton më shumë vjeshtën sesa verën.

Të gjithëve, urimi i Papës: “Të diel të gëzuar e drekën e mirë!”.



Dom Lush Gjergji
Prishtinë

PAPA FRANÇESKU NË SHQIPËRI – POROSI DHE TRASHËGIMI PËR NE (21 tetor 2014)

(Me rastin e vizitës historike të Papa Françeskut në Shqipëri)

Gjithnjë jetoj dhe përjetoj skenat madhore të kësaj vizite baritore Kishës Katolike në popullin shqiptar, Shqipërisë, të gjithë shqiptarëve në Ballkan, në Evropë dhe në botë. Ishte një takim, edhe më tepër përqafim, mes Papës dhe neve, kur hapte dorën për të përshëndetur dhe bekuar morinë e popullit nga aeroporti “Nëna Tereze”, nëpër sheshin “Nëna Tereze”, nëpër rrugët e Tiranës. Kudo brohoritje, gëzim, ngazëllim, kënaqësi, shikime në sy ndaj Atit të



Shenjtë, pastaj ndaj njëri-tjetrit, si ta pyesnin njëri-tjetrin: a është e vërtetë, e mundshme, reale kjo, apo po ëndërojmë?

Fatbardhësisht është e vërtetë! Papa Françesku ishte në Tiranë, në Shqipëri, në vizitë baritore mbarë popullit shqiptar. Unë këtë ngjarje e kam cilësuar si “mrekulli” dhe dhuratë të Zotit, të Kishës, të Papës për shumë arsye, ndër të cilat janë ato që vetë Papa Françesku i ka cekur: **martirizimin dhe bashkëjetesën ndërjetare.**

“E para sepse shqiptarët kanë arritur të krijojnë një shtet të unitetit kombëtar midis tri feve kryesore të shqiptarëve, islamizmit, ortodoksisë dhe katolicizmit, falë një Këshilli Ndërfetar që vepron me shumë ekuilibrim”. Kjo tha Papa është një gjë e mirë dhe shtoi se, “Prania e Papës (në Shqipëri) do të shërbejë për t’i thënë të gjithë popujve të botës se është e mundur të punohet dhe të veprohet së bashku.”

Arsyeja e dytë me rëndësi pse ai po viziton Shqipërinë në shtator, ka të bëjë me historinë e Shqipërisë, e cila sipas tij, ishte unike ndër vendet ish-komuniste, kushtetuta e së cilës ndalonte me ligj fenë dhe se ishte shpallur vend ateist. “Të merrje pjesë në meshë, ishte kundër kushtetutës” së regjimit

komunist, u tha Papa gazetarëve të huaj. *Sipas Radio Vatikanit, gjatë përgjigjes ndaj pyetjes mbi vizitën e ardhëshme në Tiranë, ai përmendi gjithashtu edhe shkatërrimin e kishave gjatë sundimit komunist dhe si përfundim, ai sot e ndjenë si detyrë që të vizitojë atë vend fisnik*”, është cituar të ketë thënë Papa.

Papa Françesku ndër të tjera tha kështu në intervistën lamtumirëse nga Shqipëria: “*Shqiptarët nuk janë tolerantë, ata janë vëllezër pa dallime feje. Së bashku kanë përballuar martirizimin, së bashku kanë ndërtuar demokracinë, së bashku jetojnë dhe veprojnë...*”.

Cila ishte porosia kryesore e pranisë dhe fjalës së Papës Françeskut në Shqipëri? Çka tha, çka gjeti në Shqipëri, çka na la si porosi dhe trashëgimi? Sigurisht se për një kohë të gjatë mjetet pamoro-dëgjimore, njerëzit, analistët do të mundohen nga këndvështrimet e ndryshme ta ndriçojnë, interpretojnë, shqyrtojnë, trajtojnë këtë vizitë, çastet kulmore, fjalimet, gjestet, mbi të gjitha jehonën dhe domethënien për ne dhe për botën e sotme. Unë do t’i theksoj disa elemente të rëndësishme dhe shumë aktuale.

1. Lashtësia e krishterimit ndër ne

Papa Françesku ndër të tjera ka çmuar dhe përkujtuar, për ne dhe për botën, një gjë të madhe dhe të rëndësishme, që shpesh harrohet apo anashkalohet, historinë e krishtërimit tonë që nga kohët apostolike, pra, lashtësinë tonë si të krishterë, sepse ishin ndër të parët e këtyre trojeve që e kemi pranuar Krishtin dhe porosinë ungjillore. Ja fjala dhe theksimi i Papës Françeskut në homeli lidhur me lashtësinë e krishtërimit tonë: “*Paqe në shtëpitë tuaja, paqe në zemrat tuaja, paqe në Kombin tuaj!... Ata që kishin frikë nga e vërteta e nga liria, bënë ç’ish e mundur ta dëbonin Hyjin nga zemra e njeriut e ta përjashtonin Krishtin e Kishën nga historia e vendit tuaj; ndonëse ai që më të hershmit që mori dritën e Ungjillit... Në Leximin e dytë, dëgjuam të përmendet Iliria, në kohën e apostullimit të Palit, përfshirë edhe trojet e Shqipërisë së sotme...*”.

Të mërkurën, më 24 shtator 2014, në Audiencën e Përgjithshme në Romë, Papa Françesku përkujtoi dhe komentoi kështu udhëtimin e tij në Shqipëri: “*Falënderoj edhe një herë Zotin, sepse, në këtë Udhëtim, më dha mundësinë të takohem me një popull të guximshëm e të fortë, që nuk u përkul para dhimbjes. Vëllezërve e motrave të Shqipërisë u përsëris ftesën për të pasur guximin e së mirës, për të*

ndërtuar të tashmen e të ardhmen në vendin e tyre e në Evropë”.

2. Martirizimi shekullor

Kjo gjë na ka kushtuar shumë gjatë shekujve, nën sundimin e parandorisë romake, gjatë dyndjeve të popujve sllavë, në sundimin pesëshekullor turko-otoman, sidomos nën sundimin e egër komunisto-ateist me martirët e lavdishëm. Papa Françesku ndër të tjera në homelinë e Meshës në Tiranë tha “*Duke sjellë përsëri në mendje dhjetëvjeçarët e vuajtjeve mizore e të pesëkujtimeve të egra kundër katolikëve, ortodokëve, myslimanëve, mund të themi Shqipëria ka*



qenë tokë martirësh: shumë ipeshkvij, meshtarë, rregulltarë e besimtarë laikë e paguan me jetë besnikërinë e tyre... Zoti ishte pranë jush, të dashur vëllezër e motra, për t'ju mbajtur në këmbë; Ai ju priu e ju ngushëlloi e, së fundi, ju ngriti lart mbi krahët e shqiptonjës, siç pati bërë me popullin e lashtë të Izraelit... Uroj që Shqiponja, të cilën e shikojmë në flamurin e vendit tuaj, t'ju kujtojë gjithnjë shpresën, për të mbështetur përherë besimin tuaj në Hyjin, që nuk zhgënjën, por është gjithnjë afër nesh, posaçërisht në çaste të vështira... Kishë, që jeton në këto troje të Shqipërisë, falënderit për shembullin e besnikërisë ndaj Ungjillit. Shumë nga bijtë e bijat tuaja vuajtën për Krishtin, edhe deri në flijim e jetës...”.

Përshtypja më e thellë e Papës Françesku ishte mbrëmësorja në katedralen “Shën Pali” në Tiranë, pas dëgjimit të vëmendshëm ta dy dëshmimeve rrëqethëse të Don Ernest Troshanit dhe motrës Maria Kaleta. Papa qau. Së bashku me të qajtem edhe ne. Ishin lot gëzimi, rrënqerhjeje, tronditjeje, aq sa Papa e la tekstin e përgatitur dhe foli në mënyrë spontane. “*Nuk e kam ditur se keni vuajtur kaq shumë... Sot kam prekur me dorë martitrët...Feja e vëretë është burim paqeje e jo dhune! Askush nuk mund ta përdorë emrin e Hyjit për të ushtruar dhunë. Të vrasësh në emër të Hyjit është sakrilegj i madh. Të diskriminosh në emër*

të Hyjit është çnjerëzore...Vijoni të jeni për vendin tuaj, e jo vetëm, shenjë që tregon se janë të mundura marrëdhëniet e përzemërta të bashkpunimit të frytshëm ndërmjet njerëzve me përkatësi të ndryshme fetare... Jam befasuar shumë... nuk e dija që populli juaj ka vuajtur kaq shumë...”.

Në Audiencën e Përgjithshme të mërkurën pas vizitës në Shqipëri, Papa Françesku, prapë iu kthye përjetimeve dhe vlerësimeve të këtij takimi, ku ndër të tjera tha kështu: “*Prandaj, martirët nuk janë të mundur, por fitimtarë: në dëshminë e tyre heroike shndrit sërish gjithpushteti i Zotit, që gjithnjë e ngushëllon popullin vet, duke hapur udhë të reja e horizonte shprese. Këtë mesazh shprese, bazuar në fenë e Krishtit e në kujtimin e së kaluarës, ia besova krejt popullsisë shqiptare, të cilën e pashë entuziaste dhe të gëzuar në vendet e takimeve e në kremtime, ashtu si edhe në rrugët e Tiranës...”.*

Papa Françesku duke folur në mënyrë spontane për simbolin tonë kombëtar, Shqiponjën, ndër të tjera përkujtoi dhe tha se ajo e ka çerdhen e vet, por fluturon në lartësi, figurë tejet e bukur dhe domethënëse për popullin tonë, dhe di rishtas të kthehet në çerdhen e saj.

“*Shqiponja jonë” e Lumja Nëna Tereze, është pa dyshim fryt i martirizimit dhe bashkëjetesës, vëllazërisë gjithshqiptare, që ajo e ka realizuar në mbarë botën me fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë.*

3. Popull i ri dhe shpresëdhënëse

Jemi populli më i ri në Evropë, me shumë gjallëri dhe vullnet për jetë dhe për punë. Këtë e ka hetuar edhe Papa Françesku, i cili risnisë sonë ia dha një frymëzim për jetë, ardhmëri, duke u ruajtur prej “tundimeve” të sotme, siç janë materializmi, konsumizmi, hedonizmi, relativizmi dhe ateizmi praktik. Ai në mbarim të meshës në Tiranë, ndër të



tjera ia la këtë porosi rinisë shqiptare. “Me forcën e Ungjillit e me shembullin e martirëve, të dini t’i thoni “jo” idhujtarisë së parasë; “jo” lirisë së rreme individualiste; “jo” varësive e dhunës; e t’i thoni “po” kulturës së takimit e të solidaritetit; “po” bukurisë së pandashme nga e mira e nga e vërteta; “po” jetës së shkrirë për ideale të mëdha, por besnike edhe në gjërat e vogla. Kështu, do të ndërtoni një Shqipëri më të mirë e një botë më të mirë...”.

4. Vëllazëria dhe bashkëjetesa ndërjetare shqiptare

Në takimin e Papës Françesku me udhëheqësit e feve tjera ai ndër të tjera tha: “Është e rëndësishme që jeni këtu së bashku: është shenjë e dialogut që jetoni ditë për ditë, duke u përpjekur të lidhni me njëri-tjetrin marrëdhënie bashkëpunimi vëllazëror, për të mirën e mbarë shoqërisë... Nuk mund të dialogohet, nëse nuk nisemi nga identiteti vetjak, nuk shërben. Secili nga ne ka identitetin e vet, është besnik ndaj tij...”

shenjë që tregon se janë të mundura marrëdhëniet e përzemërta dhe të bashkpunimit të frytshëm ndër njerëz me përkatësi të ndryshme fetare...”.

Ja përjetimi dhe dëshmia bindëse e Papës Françesku dhënë të mërkurën pas vizitës së tij në Shqipëri, në Audiencën e Përgjithshme, duke thënë: “Për këtë, në qendër të këtij Udhëtimi, që një takim ndërjetar, në të cilin pata mundësi të shoh me mkënaqësi të thellë se bashkëjetesa paqësore dhe e frytshme ndërmjet njerëzve e bashkësive, që u përkasin feve të ndryshme, jo vetëm mund të dëshirohet, por është konkretisht e mundur dhe e zbatueshme në praktikë. Ata e praktikojnë! Është fjala për një dialog të vërtetë e të frytshëm, larg relativizmit, duke pasur parasysh identitetin e secilit. Në fakt, ajo që i bashkon shprehjet e ndryshme të fesë, është udha e jetës, vullneti për t’i bërë mirë të afërmit, pa e mohuar e pa e nënvlerësuar identitetin e secilit...”.

Nëpërmjet Papës Françesku ishim edhe një herë



E kështu, si vëllezër, ecim së bashku. E secili nga ne ia ofron tjetrit dëshminë e identiteti të vet e dialogon me tjetrin, së bashku, pa tradhtuar identitetin e fesë, pa e maskuar, pa hipokrizi... Të dashur miq, ju bëj thirrje të mbani dhe të thelloni traditën e marrëdhënieve të mira ndërmjet bashkësive fetare në Shqipëri dhe të ndjeheni të bashkuar në shërbim ndaj atdheut tuaj të shtrenjtë... Të gjithë bashkë, për të mirën e Atdheut e të njerëzimit! Vijoni të jeni për vendin tuaj, e jo vetëm,

në “skenën botërore” për ta treguar dhe dëshmuar para Papës, para mbarë botës, kush kemi qenë dhe jemi si shqiptarë dhe si fetarë, çka duam, presim dhe kërkojmë prej njëri-tjetrit, prej botës, cili është orjentimi dhe përcaktimi ynë kulturor, shpirtëror dhe shoqëror, për të tashmen dhe për ardhmerinë tonë sa më të mirë.

Knl q Ecnpec Dpcl bm Ipeshkëv

BESIMET DHE TOLERANCAT FETARE

Feja

A mund të flasim ende për fenë në një shoqëri të shekullarizuar? Në një takim të Provincialëve Domenikanë të Evropës në 1993, ku kam qenë i pranishëm, Hervé Légrand, një teolog domenikan francez, tha se duhet të heqim dorë nga të folurit për shekullarizim, sepse ky, tha ai, është një term shumë i vagët. Le të flasim për shndërrimin social dhe, si rrjedhojë, për nevojën që ka feja për t'u inkulturuar.

Pa hyrë në diskutim rreth dallimit ndërmjet shekullarizimit dhe shekullarizmit dhe rreth

jo-praktikante, por jo që është një shoqëri jo-besimtare. Grace Davie, që përdori për herë të parë fjalinë “believing without belonging” (“Të besosh pa marrë pjesë”) për të përshkruar situatën fetare të Evropës bashkëkohore, e ilustron argumentin e saj duke iu referuar dy ngjarjeve: 11 shtatorin në New York dhe mbytjen e anijes balltike *Estonia* pranë brigjeve të Suedisë. Në këto dy raste, ku shkuan njerëzit? “Drejt e nëpër kisha”. Suedia mendohet se ka shoqërinë më të shekullarizuar në Evropë. Megjithatë populli suedez shkoi nëpër kisha; “kishat i prisnin ata dhe ata prisnin

që arqipeshkvi të artikullonte për ta kuptimin e kësaj ngjarjeje të tmerrshme”

Kur më shumë se para një dekade Jacques Delors fliste për nevojën “për t'i dhënë një shpirt Evropës” dhe kur vetëm para ca vjetësh Nikolas Sarkozy (atëherë ishte ministër i brendshëm i Francës), në librin e tij interesant *Republika, fetë, shpresa* fliste për fenë si ajo që e ushqen njeriun me shpresën shpirtërore që shteti nuk mund ta japë, sipas meje ata të dy shprehnin etjen e pashuar të njeriut për Zotin dhe nevojën themelore të njeriut për t'u bashkuar me



përkufizimeve të ndryshme që u jepen njërës apo tjetrit, unë dëshiroj vetëm të nxjerr në pah mënyrën me të cilën përkufizohet zakonisht procesi i shekullarizmit. Përgjithësisht përkufizohet si procesi me të cilin Zoti përjashtohet fillimisht nga jeta publike, pastaj nga jeta familjare e në fund edhe nga jeta personale.

Por, a mund të pohojmë, në rrethanat aktuale, se ne jetojmë në një botë nga e cila është përjashtuar Zoti apo besimi në Zotin? Shumë sociologë bashkëkohorë të fesë, si Peter Berger, Francis Fukuyama dhe Grace Davie thonë se kjo nuk ngjan.

Është e vërtetë se praktikimi i fesë është duke u zbehur në shumë vende perëndimore, por kjo nuk do të thotë se njeriu bashkëkohor është bërë jo-besimtar. Më së shumti mund të themi se kjo është një shoqëri

Zotin. Askush dhe asgjë, as antiteizmi militant i Enver Hoxhës, nuk mund ta çrrënjosë dëshirën shpirtërore për Zotin. Njeriu nuk mund ta mohojë zotin pa mohuar edhe vetvetën në të njëjtën kohë. Shën Agostini e përshkruante dëshirimin për Zotin me shprehjen e famshme: “O Zot, ti na ke bërë për vete dhe zemra jonë është e paqetë derisa të mos qetësohet në ty.”

Toleranca fetare

Papa Gjoni XXIII në letrën enciklike *Pacem in terris* të botuar në vitin 1963 (pak para se të vdiste) e konsideronte lirinë fetare si njërin ndër të drejtat themelore të njeriut që mbështetet në dinjitetin e personit njerëzor. Deklarata e Koncilit të Vatikanit *Mbi lirinë fetare* shpjegon në vijimësi se kjo liri do të

thotë se askush nuk mund të detyrohet të veprojë kundër bindjeve të veta në çështje fetare as privatisht as publikisht. Për më tepër ai pohon se “kjo e drejtë e personit njerëzor për të gëzuar lirinë fetare duhet të njihet në rendin kushtetues dhe madje të bëhet një e drejtë civile” (n.2). Kjo deklaratë përshëndeti edhe faktin se “liria fetare është shpallur gjithmonë si e drejtë civile në shumicën e kushtetutave dhe gëzon një pranim solemn në disa dokumenta ndërkombëtarë” (n. 15).

A është ende e domosdoshme të flasim për liri dhe tolerancë fetare në botën post moderne dhe post-1989? A është e përputhshme me shoqërinë pluraliste mostoleranca fetare? Apo, a është e imagjinueshme se si mund të jetë e mundshme mostoleranca fetare në një shoqëri pluraliste?

Unë mendoj se deri jo më shumë se 60 vjet më parë (domethënë deri në fund të luftës së dytë botërore; disa thonë deri në vitet 1960) një përkufizim i shoqërisë përfshinte domosdo disa bashkësi idesh. Kjo bashkësi idesh përfshinte besime fetare dhe standarde morale të përbashkëta. Moskonformizmi fetar ishte i lejuar vetëm nëse ishte diçka private. Kjo gjë ndodh edhe sot e kësaj dite në disa vende.

Por, epoka e re e postmodernizmit solli me vete atë që ne tani e quajmë pluralizëm, jo vetëm politik, por edhe kulturor, fetar, etj. Në këtë kontekst, toleranca përkundrejt dallimeve politike, kulturore dhe fetare shpreh një gjë të bukur e të mirë. Por pluralizmi ka edhe efektet e veta anësore. Dëshiroj të rendis vetëm dy prej tyre.

Në radhë të parë, pluralizmi priret të relativizojë parimet morale dhe vetë konceptin e fesë. Kjo pastaj mund të çojë në një qëndrim neutral përballë vlerave. Por ky është keqkuptimi i tolerancës. Tolerancë dhe bashkëjetesë paqësore nuk do të thotë flijim i vlerave absolute morale dhe i besimeve fetare.

Një efekt i dytë anësor i pluralizmit është ai që unë e quaj si paradoksin e madh ose si ironinë e pluralizmit: lindja e formave të reja të konflikteve dhe mostolerancës. Jonathan Sacks, kryerabini i bashkësive hebraike të Commonwealth-it britanik, në librin e tij shumë interesant *The Persistence of Faith*, bën këtë vërejtje: “Pluralizmi na bën të presim një rritje të tolerancës, ndërsa në fakt përgatit terrenin për forma të reja mostolerance. Duke zhveshur dhe privatizuar konceptin e së mirës së përbashkët, ai kërkon të thotë se asnjë pozicion nuk është i detyruar të caktojë marrëveshje me realitetin e dikujt tjetër. Nuk është një rastësi që, me rritjen e pluralizmit është rritur edhe tensioni racist dhe antisemitizmi”. Dhe në fakt, diçka e tillë është vërtetuar edhe në shumë vende ish-komuniste, por edhe në disa vende të Evropës perëndimore, ku janë zhvilluar disa forma të reja të fundamentalizmit, të nacionalizmave të rrezikshme

dhe të racizmit e të nazizmit.

A mund të jenë fetë burim konflikti dhe mostolerance? Kënga popullore e John Lennon-it *Imagine* ëndërron për një botë në të cilën nuk do të ketë më fe dhe kjo gjë, thotë ai, do të sjellë një jetë të paqme, sikurse feja është guri i vetëm apo kryesor tek i cili pengohet një shoqëri paqësore.

Ish Arqipeshkvi i Canterbury-s Dr. George Carey ka pohuar se feja “është shpesh një lidhës i fuqishëm për shoqëritë dhe kulturat, një pjesë e kuptimit themelor që ata kanë për veten. Dhe atje ku lindin konflikte ndërmjet bashkësive të përkufizuara në këtë mënyrë, politikanët apo njerëz të tjerë përdorin shpesh fenë si një mënyrë për të justifikuar apo për të thelluar konfliktin.”

Edhe në kohët tona e kemi parë vërtetësinë e këtij pohimi. Le të mendojmë vetëm për konfliktet në Ballkan, ku feja është instrumentalizuar nga politikanët, të cilët i kanë dhënë një fizionomi fetare luftërave që kanë ndezur, gjoja se këto janë konflikte ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve ortodoksë. Apo konfliktet në Irlandën e Veriut, ku konflikti ndërmjet pro-britanikëve dhe pro-irlandezëve kanë marrë formën e konfliktit ndërmjet protestantëve dhe katolikëve.

Princi El Hasan bin Talal ka pasur me siguri të drejtë kur ka pohuar në asamblenë e përgjithshme të Konferencës Botërore për Fenë dhe Paqen të mbajtur në Amman, Jordani në nëntor 1999: “Ato konflikte që përshkruhen si 'konflikte fetare' zakonisht kanë të bëjnë pak me fenë dhe edhe më pak me doktrinën fetare”. Me një frymëzim të ngjashëm, Bodo Hombach, në një fjalim të mbajtur në Budapest një vit pas konfliktit në Kosovë, gjatë kohës që ishte koordinator i paktit të stabilitetit për Evropën Juglindore, ka bërë këtë pohim të guximshëm: “Paqja dhe pajtimi janë termat fetare kyçe për kohët tona. Por ne duhet të jemi të vetëdijshëm se së voni dhe jo shumë larg prej këtij, njerëz cinikë dhe të pangopshëm e kanë instrumentalizuar fenë për të ndihmuar përhapjen e flakëve të konfliktit, me qëllim që të arrinin qëllimet e tyre brutale, e disi ekonomike.”

Fetë janë në favor të paqes, sepse fetë janë shprehje e besimit në Zotin dhe e bashkimit me Zotin, krijuesin e gjithë njerëzimit. Këtu qëndrojnë themelet e vëllazërisë së vërtetë dhe e paqes së kulluar. Nëse në disa rrethana duket se kjo gjë nuk është e vërtetë, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një keqkuptim apo instrumentalizim të fesë dhe të vetë Zotit. Nuk mund të shpallet asnjë luftë në emër të Zotit.

Përtej tolerancës

Shqipëria është krenuar gjithmonë për traditën e bashkëjetesës paqësore ndërjetare dhe kjo është e drejtë. Pak para vizitës së tij në Shqipëri më 25 prill

1993, Papa Gjon Pali II ka thënë: “Dëshiroj me gjithë zemër që kjo vizitë të shërbejë për të përforcuar lidhjet tradicionale të bashkëjetesës vëllazërore që ka karakterizuar gjithmonë marrëdhëniet ndërmjet feve të ndryshme në atdheun tuaj.” Shkëlqesia e Tij Zoti Alfred Moisiu, President i Republikës, në fjalimin që ka mbajtur për ambasadorët shqiptarë me mision në vende të ndryshme më 30 gusht 2002 ka thënë këto fjalë: “Nuk mund të injorojmë praninë e feve të ndryshme në atdheun tonë, por duhet të vlerësojmë rolin e tyre për krijimin e një atmosfere tolerance në shoqërinë tonë. Shqipëria mund të krenohet për bashkëjetesën harmonike të bashkësive fetare. Një karakteristikë themelore e qytetërimit shqiptar është toleranca fetare dhe kjo nuk lë hapsirë për asnjë lloj fondamentalistësh.”

Por deri në ç’pikë po japim dëshmi për një bashkëjetesë paqësore që shkon përtej tolerancës së thjeshtë? Toleranca është vetëm minimumi i mjaftueshëm që kërkohet për një bashkëjetesë paqësore. Unë jam në rregull, ti je në rregull; unë shoh punën time dhe ti shoh punën tënde. Feja kërkon më shumë se kaq.

Nuk mjafton vetëm të pish një kafe me një ortodoks, me një musliman apo me një bektashian me rastin e pashkëve apo të bajramit.

Në këtë pikë i referohem një teologu ortodoks rus, Oliver Clement, i cili ka krijuar shprehjen *partneritet profetik*. Me fjalë të tjera, ne duhet të bëjmë përpjekje të përbashkëta për të zbuluar rolin e përbashkët profetik të feve tona.

Këtu duhet të theksojmë rëndësinë e dialogut ndër-fetar. Me fjalën 'dialog' nuk nënkuptoj rrugën drejt relativizmit, drejt kompromisit ideologjik apo doktrinor, drejt sinkretizmit dhe as rrugën drejt pranimit pasiv të të qenit tonë të ndryshëm; nuk nënkuptoj një *modus vivendi*, dhe as vetëm një bashkëekzistencë paqësore. Siç e ka nxjerrë në pah me të drejtë Joseph Ellul: “Dialogu ndër-fetar është i themeluar mbi respektin e ndërsjellë, por edhe mbi sinqeritetin dhe guximin. Roli i tij nuk është të rrafshojë ndryshimet, por që t'i shohë ato si një mjet që ndihmon për të krijuar mirëkuptim të ndërsjellë, respekt dhe pasurim. Kjo do të thotë të ruash identitetin tënd fetar dhe në të njëjtën kohë të respektosh identitetin e tjetrit; kjo do të thotë edhe të dëgjosh, edhe të flasësh. Bëhet fjalë për një sfidë të

përhershme për të thelluar fenë përkatëse, në një kohë që edhe vlerëson fenë e tjetrit”.

Që të zbulojmë rolin tonë të përbashkët profetik duhet në radhë të parë një besim në Zotin e vetëm të vërtetë që është dashuri; një besim në dinjitetin tonë si njerëz të krijuar nga Zoti në shëmbëllimin e tij dhe një besim në thirrjen tonë të përbashkët për ta njohur Zotin, për ta dashur atë, për ta ditur se ai na do ne, për t'u bashkuar me të dhe për ta dëgjuar. Në mesazhin e tij për Ditën Botërore të Paqes më 1 janar 2002 Papa Gjon Pali II ka theksuar rolin e veçantë të



udhëheqësve fetarë të krishterë e jo të krishterë. Ai ka thënë se këta duhet të bashkëpunëojnë për të çrrënjësuar shkaqet shoqërore dhe kulturore të terrorizmit, duke shpallur dinjitetin e personit njerëzor, dhe se duhet të angazhohen së bashku për promovimin e paqes.

Do të doja ta përfundoja këtë kumtesë duke cituar mesazhin përfundimtar të Asamblesë Ndërfetare që është mbajtur në Vatikan në tetor të vitit 1999: “U bëjmë apel udhëheqësve fetarë që të zhvillojnë shpirtin e dialogut brenda bashkësive të tyre përkatëse dhe që të jenë të gatshëm të hyjnë vetë në dialog me shoqërinë civile në të gjitha nivelet. U bëjmë apel të gjithë udhëheqësve të botës, në çfarëdo fushe të influencës, që të refuzojnë ta përdorin fenë për të nxjerrë urretje dhe dhunë; që të refuzojnë ta përdorin fenë për të justifikuar diskriminimin; që ta respektojnë rolin e fesë në shoqëri në nivelet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore; që ta çrrënjësin varfërinë dhe që të përpiqen për të vendosur drejtësi shoqërore dhe ekonomike”.

Unë mendoj se këto fjalë na parashtrojnë një program të shkëlqyer për një dialog të mtejshëm ndër-fetar dhe për bashkëpunim.

Don Nosh GJOLAJ
Podgoricë

TOLERANCA I KA KUFIJT - KULTIVIMI I DURIMIT (Pjesa e dytë)

Në qoftë se Hyji, njeriun e krijon unikë, edhe mua më ka krijuar unikë, prej kah kam unë kompetencë, të drejtë t'i imponoi mendimet e mia, pikëpamjet apo jetën filozofike tjetrit? Por dashuria është ajo fuqi që e tejkalon murin dhe bunkerët e brendshme, dhe njëherë jep aftësi për t'ia ruajtur edhe unin (egon) tjetrit dhe vetes. Për këtë arsye njeriu i shëndoshë do të ushtrohet gjithëherë në tolerancë.

2. Frika dhe pasiguria e tjetërsojnë njeriun. Njerëzit e pasigurt në vetvete janë mjaftë të frustruar, dhe vuajnë nga frika e tjetrit, nga i huaji dhe ndikimi i tij. Personi i tillë, do ta ndërtojë përreth vetes murin mbrojtës prej tjetrit, dhe bëhet i padurueshëm dhe mos të themi paranoik. Pasiguria e tij buron nga thellësia e brendshme, qoftë ajo e vetëdijshëm qoftë e pavetëdijshme, por ai nga tjetri kërkon jo vetëm miratimin e mendimit apo qëndrimit të tij, por edhe me menduar si ai. Është karakteristika e njerëzve me pikëpamje moniste, fanatikëve, fundamentalistëve në vështrimin e keq të fjalës. Po ashtu shprehet pasiguria nëpër mes padurimit, janë mjaftë nervoz, të padurueshëm, pa ndonjë tolerancë ndaj tjetrit. Nga mjedisi kërkojnë përkrahje, që ishte karakteristika e diktatorëve, siç ishte Enver Hoxha, Stalini, Franku, Tito etj. Sepse ata nuk mund t'i durojnë mendimet dhe propozimet e tjerëve, sado të janë të arsyeshme. Mos flasim për pikëpamjet dhe shikimet në jetë apo në filozofinë e jetës. Ai në mënyrë jo të vetëdijshme apo pavetëdijshme është e rrezikuar pasiguria e tij. Politikanët menjëherë shohin armikun e përbetuar që kurdisë kundërrevolucionin, grusht shtetin. Me një fjalë në çdo njeri e sheh armikun potencial, që duhet të zhduket sa më parë, se për ndryshe, ai do të zhduk atë. Në bashkësinë martesor zakonisht partneri i tillë është i ngarkuar, se ai tjetri bashkë partneri do ta sundoi, do të bëhet shërbëtor i gruas apo anasjelltas. Vetvetiu aktivizohet refleksi mbrojtës, që është i gatshëm për t'u kacafytur, për ta ruajtur identitetin e rrezikuar. Vetveten e bllokun dhe fuqitë krijuese rikthehen në strategjinë për t'u mbrojtur, ashtu jo vetëm se i krijon vetes kokëçarje por edhe tjetrin e merr në qafë dhe vend të mbretëroi dashuria, dialogu, partneriteti, fillon të mbretërojnë kanibalizmi shpirtëro dhe ferri i tmerrshëm. Mos toleranca dhe mos pranimin i tjetrit janë shkaktar e luftës, konflikteve, grindjeve posaçërisht në bashkësinë martesore. E arsyeshme është lufta pa kompromis për ta çrrënjosë nga thellësia e brendshme pasigurinë, frikën. Në qoftë se Hyji, njeriun e krijon unikë, edhe mua më ka krijuar unikë, prej kah kam unë kompetencë, të drejtë t'i imponoi mendimet e mia, pikëpamjet apo jetën filozofike

tjetrit? Por dashuria është ajo fuqi që e tejkalon murin dhe bunkerët e brendshme, dhe njëherë jep aftësi për t'ia ruajtur edhe unin (egon) tjetrit dhe vetes. Për këtë arsye njeriu i shëndoshë do të ushtrohet gjithëherë në tolerancë. Në qoftë se partneri ka tejkaluar në opsesionin e sëmurë, të një ide fikse, dhe si i tillë është i padurueshëm a ndaj njerëzve me një sjellje paranoike. Prognoza për shërimin e tij është minimum. Partneri i tillë është i padurueshëm.



Pikëpamjet dhe mendimet e tija fare nuk përputhen me mjedisin e tij. Ai reagon në mënyrë hysterike apo paranoike. Kuptohet vetvetiu se reaksionet emotive janë në nivelin e ulët dhe të paarsyeshme dhe nuk i përgjigjen fare realitetit. Personi i ngarkuam me këtë sëmundje, e cila ka kaluar në ide fikse apo dhunuese, fare nuk i këshillohet martesa. Në qoftë se dikush edhe në tipat e tillë dashurohet atëherë, ata të cilët mendojnë të martohen me tipat e tillë, duhet të llogarisin, se partneri i tillë jo vetëm se nuk të jep asnjë farë lirie, por nuk lejon as shprehjen e mendimit të lirë. Në anën e tjetër ata do të bie në kundërshtime edhe me ligjet e shteteve të qytetëruara. Njeriu si individ dhe krijesë e Hyjit, ka të drejtë në mendimin e lirë, në pikëpamjet e jetës dhe filozofisë, e drejta në gjuhë, komb, fe dhe në sjellje

etiko-morale sipas ndërgjegjes personale. Po qe se ndodh partneri i dëmtuar vetëdijesohet pas martesës, dhe e vëren se bashkë partneri i tij vuan nga kjo sëmundje, në këtë rast si të sillemi me të? Në qoftë se partneri është aq shumë i sëmurë dhe i shëmtuar, derisa shokut të martesës nuk ia pranon dhe nuk ia lejon asnjë farë të drejte që i takon. Atëherë është e mundur, shoku i martesës i cili është sulmuar dhe i dëmtuar nga bashkë partneri i sëmurë, të vazhdoj jetën me bashkë partnerin e sëmurë, por sillet ndaj tij si ndaj pacientit, i cili ka nevojë për asistencën e tjetrit - në këtë situatë mjekut! Kuptohet në këtë rast partneri i dëmtuar nuk do ta kërkoj drejtësinë drejtpërsëdrejti nga organet e kompetente (gjyqësore), por mbetet tolerant ndaj partnerit të sëmurë. Atëherë është shumë e rëndësishme për partnerin e dëmtuar, ta posedojnë stabilitetin dhe unin e fortë, ta ketë baraspeshën e jetës, sepse atij i duhet ta kuptoj dhe ta përfetojë bashkë partnerin e sëmurë jo vetëm si pacient, por edhe si individ, i cili është ngarkuar me frustrime të llojllojshme të jetës, që ende nuk i ka zgjidh, as nuk është shkundur nga barra e të kaluarës. Nga partneri i shëndosh, kërkohet edhe njohuri psikologjike, i cili nuk bënë ta ngacmoj bashkë partnerin e sëmurë posaçërisht në ato pikat e dobëta "thembra e Akilit". Sigurisht as kush prej neve, nuk dëshiron, as nuk kishte me ardhur në këtë ide, që ta godasin edhe më tepër plagët të plagosurit duke i shkaktuar edhe plagët e reja. Parimisht partneri i shëndosh, në qoftë se e pranon të jetojë me bashkë partnerin e sëmurë, me këmbëngulje qëndron në pozitat objektive, atëherë ai nuk bënë ta ngarkoj vetveten me disfatë-fitore (do të fijoje ose do të ç'mëndëm). Thotë një fjalë: "dashuria kupton dhe dashuria mbron!" Këmbëngulja e paluhatshme dhe ekskluzive janë shenjat e një mungesës si ndjenjave (emocioneve) ashtu edhe vlerave objektive, atëherë është e rëndësishme të ushtrohet toleranca deri në atë masë, që mund ta duroj kritiken dhe kundërshtimet.. Kjo nuk do të thotë se duhet me heshtet, siç është deviza "i mençmi lëshon pe", dhe si i tillë i kalon të gjitha kufijtë e tolerancës. Durimi i ka edhe kufijtë e vet. Kufiri është aty ku të kërcënohet ekzistenca nga bashkë partnerit, apo jeta e përbashkët bëhet e pamundur dhe rruga e përbashkët të çon vetëm kah vetëvrasje. Aty nuk ka çka të pritët! Njeriu nuk guxon, as për hir të tolerancës, as për hir të martesës, as për hir të dashurisë, ta tradhtoj qëllimin e jetës, duke bërë vetëvrasje në mënyrë direkt apo indirekte, sepse i kundërshton urdhrin e Zotit "Mos vra!" Bashkësia martesore duhet të ndërpritet edhe atëherë kur bashkë partneri fton tjetrin për ndonjë krim, ose kërkon prej tjetrit ta mohoj fenë, botëkuptimin, pikëpamjet filozofike të jetës, ta shkelin ligjin etiko-moral dhe idealin. Një kërkesë e tillë shkatërron dhe

nuk ndërton. Atëherë duhet të ndërmerret pa ndonjë kusht hapi vendimtar që është me pajtimin e fjalëve të Jezu Krishtit: "Keni dëgjuar se qe thënë: 'Mos e the kurorën!' E unë po ju them: kushdo që me dëshirim e shikon një grua, në zemrën e vet e ka bërë fëlligështinë me të. Nëse syri yt i djathtë të çon në mëkat, nxirre e flake larg teje! Është më mirë për ty të humbasësh njërin nga gjymtyrët e tua, se i tërë trupi yt të hidhet në ferr. E nëse dora jote e djathtë të çon në mëkat, preje e hidhe larg teje! Është më mirë për ty të humbasësh një gjymtyrë se i tërë trupi yt të hidhet në ferr." (Mt 5,27-30). Martesa si e tillë nuk është parimisht e pandashme, ajo ndahet atëherë kur njeriu i këput lidhja me Zotin.

Kurora e martesës nuk i përket vetëm dy vetave!

Kurora e martesës nuk i përket vetëm dy vetave burrit dhe gruas por Hyjit, përpara të cilit është vulosë. Ata dy nuk janë më dy por një çift për para Hyjit. Bashkëshortja duhet me qenë e paprekshme për çdo njeri. I krishteri duhet të mësohet ta shikojnë me syrin e Zotit. Epshi është atakët në bashkësinë martesore dhe e ngarkon ndërgjegjen si në "mendje" po ashtu edhe "në zemër". Njeriu nuk bënë që të arsyetohet as me "zërin e natyrës" as me "natyrën e përbashkët"! Për botën e sotme janë të pakuptueshme një radikalizëm i tillë siç është me pre dorën, këmbën, hiq syrin në qoftë se të shkandullon. Me tjera fjalë njeriu duhet dita-ditës me punuar me vetvete, për ta luftuar të keqën. Çdo gjë që pengon për fënikërimin e njeriut duhet ta hedhim, sado është për neve vlerë personale. Si bie fjala, për dikën mund të jetë automobili, për tjetrin para, fjala vjen, mjeku është i nderuar, por në qoftë se mjeku gjinekolog bashkë punon me tjerët në abortim - në mbytjen e njeriut të pafajshëm, atëherë është më mirë për të të humbasësh këtë profesion se tërë trupin yt të hidhet në ferr. Po ashtu vlen edhe për çiftin martesor, më mirë e humbë bashkë partnerin se tërë trupi yt të hidhet në ferr. Ja një shembull tragjik, që ndodhi para disa vitesh në Gjermani. Para gjyqit për të mitur, u gjet një grua e re, e cila dënohet me dhjetë vite burg - që është gjoha maksimale për vitet e saja - sepse ajo ka bashkëvepruar në vrasjen e dyfishtë, që i ka bërë burri i saj, duke vrarë dy vajza të reja. Ajo megjithatë nuk i largohet dhe as nuk distancohet prej burrit vrastar, po ashtu as nuk e pengon për mos ta kryejnë edhe krimin e tretë, i cili tentoi për ta realizuar. Në këtë rast, ajo bëhet bashkë pjesëmarrëse me partnerin e çmenduar - edhe pse është një tragjedi e madhe për grua - asaj i duhet me të drejtë me qenë e gjobitur. Sa do është e madhe vlera e bashkësisë martesore, kur është në pyetje ndërgjegjja, pikëpamjet e jetës etiko-

morale atëherë është ma mirë ta humbasësh bashkëshortin (bashkëshorten) dhe të shkuroresh se sa tërë trupi yt të hidhet në ferr! Jeta e përbashkët me bashkë partnerin e sëmure dhe të pashërueshëm jo vetëm që i shpie fëmijën në vorbullën vdekjeprurëse, por edhe ti si bashkë partnerë merr përgjegjësin mbi vete. Zakonisht alkoolikët e rënd, sëmurit psikik, kriminelët dhe fanatikët ideologjik dhe fetar nuk janë për martesë.



3. Fuqia e marrëveshjes është tek “Po qe se burri im ndryshon atëherë do të ishte gjithçka në rregull”. Po i njëjtin konstatim e kanë edhe burrat për grat e veta: “Po qe se gruaja ime është e drejtë dhe fisnike, jeta e jonë do të ishte krejtësisht ndryshe!” Vërtetë gjendemi përpara një faktit: raporti dhe marrëdhëniet reciproke mes partnerëve. Zakonisht ne nuk i pranojmë njerëzit, as bashkë partnerin ashtu siç është, por dëshirojmë, ai të hyjë në kornizat e pikëpamjeve të mia, dëshiroj të jetë ashtu siç dëshiroj unë dhe jo si është ai në vetvete. Çka të bëjmë atëherë? Njeriut nuk mund t'i zëvendësojmë kokat. Po ashtu nuk mund t'i imponojmë pikëpamjet e tjerëve. Atëherë nuk na mbetet tjetër përveç ta pranosh tjetrin ashtu siç është. Me një fjalë tjetër duhet ta ndërrosh vetveten. Nuk mendojmë me këtë pohim, se partneri duhet të shkrihet apo të asgjësohet në tjetrin, as të merret nëpër këmbë dhe t'i shkelet dinjiteti i tij nga tjetri, as ndërrimi i pikëpamjeve filozofike të jetës, as bindjet fetare dhe etiko-morale për hir të tjetrit t'i shkelësh. Por duhet të bindemi, ne jemi ata që i kemi çelësin në dorën, qoftë dialogut (bisedës) qoftë marrëdhënieve reciproke, qoftë marrëveshjeve. Parimisht duhet çdo njëri nga partnerët të fillojnë me reformën, pikërisht duke korrigjuar vetveten. Në qoftë se ia fillojmë me reformën e vetvetes, atëherë menjëherë do të bindemi, se situata fillon të ndërrohet: në vend të fajësimit, që zakonisht ia ngarkojmë tjetrit, tani e

merr përgjegjësin mbi vete. Gradualisht fillon të lind bindja se edhe tjetri ka të drejtë, dhe fillon ta pranosh ashtu siç është në realitet, dhe jo ashtu siç e dëshiroj me qenë. Fatlumturia e njeriut është në realizimin e vetvetes si person, kjo nuk vlen vetëm për ty por edhe për tjetrin që është përkaj tej. Atëherë nuk mbetet tjetër përveç të fillosh të luftosh me vetveten duke ecur kah rruga e fisnikërisë dhe shenjtërisë. Kuptohet se nuk ka ndonjë iluzion, sepse nuk ka njeri në botë që ka lind shenjt, i pjekur dhe ideal, por me orvatje këtë e fiton gjatë jetës. Një fjalë e vjetër popullore thotë: “Për shamatë duhet me qenë së pakut dy veta!” Po qe se dëshiron njeriu ta gjejë rrugën, e cila te shpie te tjetrit, atëherë duhet ta marrësh çelësin me vete. Ti duhet ta bindsh veten se nuk do të shamatolesh me tjetrin, dhe ai tjetri nuk mund të shamatohet me ty, në qoftë se ti nuk do. Për t'u kuptuar njëri me tjetrin nuk është e nevojshme me qenë dy veta, siç thotë G. Barbarini, në librin e njohur “Reforma e karakterit”. Në qoftë se njëri prej partnerëve fillon të mendoj mirë, mjafton për fillim. Atëherë mos prit te nesërmen por sot, tani filloja me menduar mirë për tjetrin: “unë dhe ti, dhe gjithçka do të jetë mirë!” Konflikte në bashkësinë martesore menjëherë fillojnë të shkrihen porsia akulli në ngrohtësinë e diellit. Mjafton vetëm prej një partnerit, ta vendosin baraspeshën mes vetes dhe tjetrit, në rastin tonë mes partnerit martesor. Ti je, ai njeri, që mund të bësh mrekulli, dhe jo ai tjetri!

4. Më mirë është të kesh qetësi se sa të drejtë! Njeriu në mënyrë instiktive më parë e ka në gojë refleksin mbrojtës, siç është arsyeja, se sa e merr mbi

vetën përgjegjësin: “Pse unë i pari me lëshuar pe!” Arsyeja shpërthen nga nënvetëdija vetvetiu në sipërfaqe. Po e njëjta gjë mund të shprehet i njëjti reagim te disa individ: “Unë jam parimisht për pajtim, por pse gjithherë unë i pari, të lëshoj pe dhe ashtu më mbet barra, përderisa tjetri rron në djersen time, jo vetëm kaq, por më në fund edhe fryhet si gjel detit. Dikush di të jetojë, e tjetri vetëm vuan dhe bartë barrën!” Konstatimi i tillë në vetvete është i vërtetë, dhe nuk mendojmë as ta mohojmë. Por është e vërtetë edhe pohimi tjetër: drejtësia ka shumë përparësi, por edhe dashuria e tejkalon egoizmin e padrejtë. Derisa partnerët nuk vetëdijesohen, se dashuria është ajo rrugë, e cila shpie kah shpëtimi i bashkësisë martesore, kah harmonia e përbashkët, deri atëherë do të vuajnë njëri nga tjetri, duke fajësuar tjetrin, i cili shfrytëzon, keqtrajton, vetëm murmurit në padrejtë që i bëhet nga ana e tjetrit. Njeriu, i cilin nuk bindet me arsyen e shëndoshtë, dhe në fund të fundi edhe i refuzon çdo lloj dialogut (bisedës), atëherë e kemi para vetes një tip të rënd dhe i papërmirësueshëm. Ai si i tillë jo vetëm se është në konfliktin e përhershëm me bashkëshorten por edhe me mjedisin. Si fjala vjen, të vine mysafiri në shtëpi, dhe të kërkon drekën, por e porosit nikoqirin, mos ta përgatisin me krip, sepse vuan nga sëmundja e veshkave, dhe ti në mënyrë të vrazhdë i thua: “Ushqimi pa krip nuk ka shije!” Megjithatë, ia përgatit ushqimet me krip, do të thonë, se ti nuk je e aftë për dialog (për bisedë). Ti e ke drejtën tënde dhe pikë. Po qe se mysafiri shkon dhe nuk kthehet më te ti, as në kafe as në bisedë. Faji nuk ishte i mysafirit por i yti, dhe tani ti duhesh ta pranosh gabimin. Pothuaj se gjithçka varet, jo prej arsyes por prej pikëpamjeve të jetës. Njeriu, i cili nga natyra nuk është komunikues dhe me këmbëngulje qëndron në pikëpamjet e veta, atëherë zakonisht i themi tipit tillë: krye fortë (kokëfortë). Zakonisht krye fortësia nuk është asgjë tjetër, përveç se e kemi përpara vetes njeriun e kufizuar. Tipat e tillë janë zakonisht të papërmirësueshëm, edukata nuk ndikon shumë për t'u përmirësuar. Ironia më e madhe është, kur ai, arsyetohet me pretekstin e drejtësisë, gjoja ai është njeri me karakter të fortë dhe shumë i përpiktë. Parimisht ai qëndron me këmbëngulje principi kokëfortësisë. Përndryshe kishte me qenë

nënvlerësim dhe poshtërsi po qe se i përulet tjetrit, dhe ia pranon vërejtjen, që ai tjetri ia drejton! Po ashtu kishte me qenë njeri labialë, po qe se e pranon gabimin ose fajin, sepse ai kurrë nuk gabon, nuk mëkaton, por gjithherë ai tjetri: “Në emër të vërtetës dhe të drejtës, unë nuk mund të lëshoj pe, nuk mund të komprometohem. Ku do të shkojmë, në qoftë se fajtori ka të drejtë! Ne të heshtim, përderisa fajtori ta ketë fjalën e fundit. Një gjë të tillë nuk e pranoj!” Po qe se bashkë partneri i tij, e sheh, se partneri me të cilin e nda fatin e jetës është mjaft kokëfortë dhe këmbëngulës në ideja fikse të tija. Ai për hir të paqes në familje, (bashkësi), kuptohet se nuk do të pajtohet me pikëpamjet e shtrembëruar, por as nuk e dënon por lëshon pe. Nuk paguhet shamata me njeriun e tillë. Sepse shamatën e shoqëron urrejtja dhe hidhërimi. Fund të fundit nuk është asndonjë shenjë dobësie, po qe se tregohesh zemërgjerë, i mirë dhe i durueshëm për hir të pajtimit. Njeriu po ashtu vlen për çdo bashkëshort në martesë, duhet të vetëdijesohet, se nuk është vlere më e madhe të kesh të drejtë, por vlere më e madhe është “të jesh i mirë” si me partnerin ashtu edhe me tjerët. Po qe se ia arrite ta bindësh edhe partnerin, i cili vuan nga principi i një anshëm. Kuptohet se drejta dhe drejtësia janë diçka të shenjta, por mirësia i tejkalon. Mirësia që e shoqëron dashuria është diçka e mrekullueshme. Me një fjalë është porsi zjarri që e dëbon të ftohtit apo e shkrin acarin! Në fund të fundit është më mirë ta pengosh urrejtjen, ankthin, frikën, pasigurinë, mëkatin se sa te qëndrosh me këmbëngulje në drejtën tënde. Mirësia është bija e dashurisë. Përderisa drejtësia pa dashuri dhe mirësi shumë lehtë shpie deri te dhuna. Njeriu, i cili nuk ka arsye të mjaftueshme, ai do te përdorin ngritjen e zërit deri edhe dhunën fizike apo psikike për ta bindur tjetrin. Njëanshmëri e përkrahjes së drejtës, shpeshherë në shpie deri në konfliktet e shumta, që i shoqëron zakonisht urrejtja. Në të kundërtën vepron dashuria dhe mirësia: gjithherë duke ikur konfliktit, urrejtjes dhe dhunës. Ai vet nuk vepron ashtu siç vepron bashkë partneri krye fortë, sepse dashuria dhe mirësia e udhëzojnë me hapat e sigurt, për të mos hyrë në vorbullën e hapave të gabuar. Fjala e moçme thotë: “Më mirë është të kesh paq dhe rahat se sa drejtësi dhe ferr!”

Silvia Guidi
Tiranë

VINÇENS PRENUSHI (1885-1949)

*Prenushi u dënua nga Enveri, nuk donte të ndante Kishën nga Papa.
Historia e jetës dhe vdekjes së priftit katolik në Shqipëri. Biseda mes diktatorit
e klerikut dhe fundi tragjik i vitit 1949 është kthyer në një shfaqje teatrale në Itali.*

“Letërsia autentike dhe diktaturat janë të papajtueshme, shkrimtari është armiku natyral i diktaturave”, shkruan Ismail Kadare, duke folur për shumë disidentë shqiptarë të persekutuar e të vrarë nga regjimi i Enver Hoxhës.

Shërbëtori i Zotit, Nikollë Vinçenc Prenushi, nuk ishte vetëm një shkrimtar i talentuar, i zoti për të bërë që të gjallonte nëpër faqe trashëgimia e pasur folklorike e vendit të tij, por ishte edhe një frat françeskan, një prift e pastor. Në Durrës e thërrisnin Thomas Becket i Shqipërisë; Prenushi vdiq më 19 mars (por data nuk është e sigurt) të vitit 1949, pasi nuk iu bind kërkesës së Enver Hoxhës për të krijuar një kishë kombëtare, antagoniste me Kishën e Romës. Ishte bërë kryepeshkop i Shqipërisë në vitin 1946, pas vrasjes së monsinjor Gaspër Thaçit dhe u gjend duke ndarë të njëjtin fat me paraardhësin.

Më 16 gusht të 1944, gjatë një procesioni për festën e San Rokos (Shën Rrokut), që zhvillohej në Shirokë, një fshat në buzë të liqenit të Shkodrës, dom Ndre Zadeja u thotë besimtarëve: “Sot dua t’ju them dy fjalë, në veçanti ju të rinjve; një re e zezë do të varet mbi kokat tuaja. Qëllimi i saj është të shkarkohet mbi ju. Atëherë nuk do të keni mundësi të bëni asgjë kundër saj, vetëm ta duroni me të gjitha të këqijat e saj e, mes tyre, edhe mohimin e Zotit”. Zadeja i tha këto fjalë rreth 7 muaj përpara se ta pushkatonin, pas murit të kishës katolike, të dielën e 25

marsit 1945. Ishte ndër të parët priftërinj në Shkodër. Nisi kështu persekutimi i madh.

Mes gjërave të para që qeveria ndërmori kundër Kishës, ishte refuzimi që iu bë hyrjes në Shqipëri të nuncit apostolik, monsinjor Leone Giovanni Battista Nigris, i cili kthehej nga Roma. Thaçi e



Prenushi u thirrën nga Enver Hoxha për të kërkuar një bashkëpunim me kusht që të shkëputeshin nga Selia e Shenjtë; të dy e refuzuan këtë propozim.

Pas vdekjes së Thaçit dhe eliminimit të Prenushit, i dënuar me 20 vjet burg të rëndë dhe i vdekur për shkak të torturave, Hoxha bëri një tjetër tentativë, duke ia rinovuar propozimin monsinjor Frano Gjinit. Por mori të njëjtën përgjigje: “Nuk do ta ndaj kurrë grigjën time nga Papa”.

Pjesa teatrale

Prenushi ka lindur më 4 shtator 1885; studioi pranë Kolegjit të Françeskanëve në Troshan, për t'u perfeksionuar më pas për Teologji, në Austri. Kreu meshën e parë më 25 mars 1908; ishte drejtori i parë i tipografisë françeskane, drejtor i Kolegjit Françeskan; në 1936 u konsakrua peshkop i Sapës e më pas u emërua Argjipeshkëv i Durrësit. Prej historisë së tij është frymëzuar pjesa teatrale “Petalja dhe lulja” (“Il petalo e il fiore”), krijuar gjatë një aktiviteti në Rimini në 2012 (dhe ende është në turne nëpër Itali dhe jashtë) “Albania, athleta Christi. Në rrënjët e lirisë së një populli”.

Autori Francesco Marchitti thotë se duke thelluar miqësinë me organizatorët, “duke iu afruar historisë së tokës së tyre, dolën në dritë shumë materiale origjinale: tregime të thella dhe histori jete, pyetje mbi domethënien dhe identitetin, takime dhe ngjarje të jetuara. Historia shqiptare është një dramë e thellë, e kthyer shumë herë në tragjedi.

Kjo ishte fara e teatrit, në kuptimin më të parë të fjalës: është shfaqja e tragjedisë, e historisë së një komuniteti dhe të një populli. Dialogu mes dy protagonistëve, diktatorit Enver Hoxha dhe Vinçenc Prenushit, simbolizon gjithë narracionin: diktatura tenton të vërë nën shërbimin e saj Kishën dhe refuzimi i pashmangshëm shpërthen një dhunë, sa të qartë aq edhe të egër. Mbërrin dënimi me vdekje, por kjo nuk do të jetë fjala e fundit.

Deus ex machina në dramë është vetë shpirti i popullit, që në profecinë e martirëve të saj të shenjtë thuhet se fati nuk është vdekja, por jeta dhe rigjetja e plotë e identitetit të vërtetë. Petalja dhe lulja, lulëzimi i tyre në skenë, është një homazh për miqtë shqiptarë, tokën dhe historinë e tyre”. Një farë “vrasjeje në katedralen e Durrësit”, e quan Antonio Zanoletti, që e ka vënë në skenë, së bashku me Fabio Sartin, në rolin e Vinçenc Prenushit, Dhurata Vrenozin dhe Emilio Zanetti në rolin e Enver Hoxhës. “Në thelb të këtij teksti qëndron përplasja mes një njeriu të fesë dhe pushtetit politik, pak si në dramën profetike të Eliotit”, thotë Zanoletti, “një

lidhje, një raport-kontrast mes problemeve të ndërgjegjes individuale dhe kolektive të një populli të tërë, që duhet të bëjë hesapet me arsyet e një politike totalitare. Një copëz historie e dhimbshme e një toke, e mbajtur për shumë kohë në hije, që thërret dhe kërkon të njihet. Në këtë pikë, teatri na vjen në ndihmë. Teatri lind atje ku do të lindë. Sot më shumë se kurrë duhet të shpërfaqet çka ka qenë gjithnjë qëllimi parësor i krijuesve të tij: vendi ku një komunitet, lirisht i bashkuar, i rizbulohet vetvetes. Në të kundërt, siç do të thoshte Testori, është pluhur, është asgjë”.

E bukura e kësaj pune, nënvizon Zanoletti, “nuk është më shumë shfaqja e performancës sime, më shumë sesa të rikthejë përmbajtjen e tekstit. Çdo emër që shqipton, është një botë që evokon”. Një vokacion ndërgjegjësues që vjen nga larg, nga vitet e fëmijërisë, i shënuar nga një shkëmbim i shpejtë batutash me Papa Montini. «Paolo VI e kam njohur personalisht; isha i vogël, por e kisha merak të thosha gjithnjë mendimin tim. Dua të bëhem aktor! Bërtita kur erdhi për një vizitë pastorale në Varezë. Përpiku të bëhesh atëherë! M'u përgjigji ai”.

Arrestimi dhe torturat

Në vitin 1945, Enver Hoxha i kërkon një takim imzot Prenushit, i cili pranon të bisedojë me ish-diktatorin. Në atë takim mori pjesë edhe imzot Gaspër Thaçi. Tema e takimit ishte shkëputja e Kishës Katolike shqiptare nga Selia e Shenjtë dhe Papa. Të dy klerikët e refuzojnë këtë kërkesë dhe pasojat ishin të menjëhershme. Më datë 19 maj 1947, imzot Prenushi arrestohet. Më datë 18 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Durrësit e përbërë nga: kryetari, major Gjon Banushi, anëtarë, major Zhule Çiriako, kapiten Halim Ramohito dhe prokuror, kapiten Petrit Hakani, hapin gjyqin. Vendimi i Gjykatës së Durrësit përcillet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë të Tiranës, bashkë me një relacion të prokurorit të Durrësit, Sotir Qiriaqi (data, 1 dhjetor 1947). Gjykata e Lartë Ushtarake, Tiranë e përberë nga: kryetar major Niko Ceta, anëtarë, kapiten Nexhat Hyseni, kapiten II Mustafa Iljazi dhe sekretar aspirant Thoma Rino, më datë 23 shkurt 1948, mbasi shqyrtoi çështjen e të pandehurve... “refuzon kërkesën e tyre”.... Gjatë procesit gjyqësor, Vinçenc Prenushi deklaroi se “lufta ime ishte kundër komunistave e Partisë Komuniste që të mos ekzistonte, kur të formohej Pushteti që mendonim me zbarkimin e amerikanëve”. Më 19 mars 1949 vdes nga torturat më çnjerëzore në burgun e Durrësit. Shpallet Martir i Demokracisë më 8 maj 1993, në Durrës.

**Frrok Kristaj
Zhym-Kosovë**

**NJË KISHË, NJË SHKOLLË, NJË BIBLIOTEKË
Atë Shtjefën Gjeçovi - kolosi i kulturës shqiptare
Në 140-vjetorin e lindjes (1874-1929)**

Atë Shtjefën Gjeçovi u lind dhe u rrit në shtratin e rilindjes kombëtare. Ishte personalitet i rrallë i fesë dhe i kombit. Ishte i nderuar nga mbarë kombi shqiptar. Ishte pishtar i devotshëm i atdhedashurisë, i arsimit dhe i kulturës shqiptare.

Një nga figurat më poliedrike që njeh historia e kulturës shqiptare, pa dyshim se ishte figura e të madhit Atë Shtjefën Gjeçovit. Ai e pati etjen e pushuar të gërmonte nga pak në të gjitha fushat e diturisë. Pra, Gjeçovi mbeti në kujtesën e të gjithëve si historian, etnograf, arkeolog, pedagog, speleolog, mbledhës i folklorit, kodifikues i “Kanunit të Lekë Dukagjinit”, përkthyes, poet, prozator, patriot, e kështu më radhë.

Atë Shtjefën Gjeçovi u lind në Janjevë të Kosovës, pikërisht më 12 korrik të vitit 1874, pra para plot 140 vjetëve, përkatësisht vdiq para plot 85-vjetve, më 14 tetor 1929. Rrjedhë nga i ati Mata (shkruan si Mata në librin e vdekjes dhe në pasaportë, kurse nëpër libra e tekste publicistike babai i Gjeçovit njihet si Konstandin), dhe e ëma Ana Guga nga Prizreni (në pasaportë shkruhet si Marije). Kur u lind Gjeçovi prindërit e pagëzuan me emrin Mëhill, që shkurtimisht e quanin Hilë.

Hili i vogël si fëmijë mësimet e para i filloi në vendlindje, pra në Janjevë, ku edhe shfaqti shenja zgjuarsie, prandaj famullitari me leje të prindërve e regjistroi në Kolegjin françeskan në Troshan afër Lezhës. Kolegjin françeskan të Troshanit, Hili e mbaroi në vitin 1888, dhe po atë vit, për studime të mëtejme, shkoi në Bosnje, ku më 15 gusht të vitit 1892, Hili, hyri në urdhrin françeskan në Kuvendin e FOJNICËS, dhe mbas vitit të provës, vazhdoi mësimet liceale e filozofike në Kuvendin e PLEHANIT (afër Dërventës), nga ku herë pas here shkon në BANJA LLUKË e në KRESHEVË për të dëgjuar leksionet e Toloteit mbi origjinën dhe lashtësinë e gjuhës shqipe.

Pas mbarimit të studimeve teologjike, më 29 qershor të vitit 1896, sipas rendit kishtar e ndërroi emrin nga Mëhill në Shtjefën, por tash quhet Shtjefën Konstandin Gjeçovi.

Atë Shtjefën Gjeçovi shërbeu në këto vende:
Në Troshan e Rubik (malësi e Lezhës) - 1896-1897;
në Pejë me filialet Zllakuqan e Gllogjan - 1897-1899;

ne Laç Sebaste të Kurbinit - 1899-1905; në Troshan – 1905; Arbneshtë të Zarës (në Kroaci) - 1905-1906; në Livno të Hercegovinës – 1906; në Shkodër - 1906-1907; në Gomsicë (të Mirditës) - 1907-1915; në Troshan - 1915-1916; në Theth - 1916-1917; në Prekal (të Shalës) - 1917-1918; në Rubik, Pejë e Troshan - 1919-1920; në Vlorë; në Rubik - 1920-1921; në Shkodër - 1921-1926; në Gjakovë - 1926-1928. Në fund në Zym të Hasit – 1928 deri me 14 tetor 1929.

“Aty ku punon, hape një Kishë, një shkollë dhe një bibliotekë”

Sipas traditës françeskane: “Aty ku punon, hape një kishë, një shkollë dhe një bibliotekë”, Gjeçovi hapi 11 shkolla shqipe dhe punoi në detyrën e mësuesit të shqipes edhe në 17 të tjera.

Themeloi bibliotekën shkollore, ekskursionin shkollor dhe koleksionin e parë arkeologjik në trojet shqiptare.

Prifti, sado që ishte i ri, kishte personalitet të formuar, kishte kulturë të gjerë e interesim për shumë fusha të jetës.

Për ndryshe, Atë Shtjefën Gjeçovi me studime në lëmi të ndryshme dhe me shkrime, kishte filluar që nga studimet, por në vitin 1900 u bë i pranishëm në të gjitha fushat e kulturës e të arsimit kombëtar. Shkroi poezi, prozë e dramë, mbledhi këngë, përralla, mite, doke e zakone popullore e mbi të gjitha, atë që do ta bënte të pavdekshëm e mbledhi dhe e kodifikoi “Kanunin e Lekë Dukagjinit”, që është monument i gjuhës e i kulturës së kombit shqiptar, për të cilin Universiteti i Lajpcigut të Gjermanisë i dha titullin “Doktor i shkencave in Honoris Causa”. Lista e veprave të tij është shumë e gjatë. Botoi, me emër të plotë, por edhe me pseudonimet Lkeni i Hasit e Komnen Kanina.

Vepra e pabotuara të Gjeçovit

“Jeta e Shën Luçis pajtores s'arkidieçezit të

Durrësit”, 1904; “Përkrenarja e Skanderbegut, Leka i Madh e Maqedonas, Pirro i Epirit, Gjergj Kastrioti, 1914; “Mendime për librin “Pushka e Tradhtarit” të Zef Harapit”, 1915; “Atdhetarët e vërtetë”, 1915; “Trashëgime Pellazge”, 1908-1912; “Rrnoftë Vlona Shqyptare”, 1920; “Mbas katërqind e tridhetë e tri vjetësh”, 1921; “Komiteti Shqyphtar” “Dielli e Hana”; “Kulshedra e dragojt”; “Bet’e shqyphtarve”; “Zojzi në Shqypni”; “Dashtnija e Atdheut” (dramë kushtuar Gjergj Kastriotit), 1901; “Rravgime” (tregim), 1903; “Kushtrimi ose Marka Kuli, kryeçitas” (dramë), 1903; “Princi i dy Dibrave” (dramë kushtuar Moisi Golemit), 1904; “Tradhti Gjaksore ose Vrasja e Marka Kulit” (dramë), 1906; “Katër të lumtun ose Edipi i Shqypnis”(dramë), 1926; “Përralla të kthyer në dialog” (dramatizime), 1926; “Koha e zgjetave” (prejardhja e Gjeçovit), 1928; “Leka i madh” (tregim i gjatë historik); “Doke dekesh mje në varr e vorcajesh mje në gjamë petkash” 1900-1907; “Rrnesa e Kombit Shqyphtar n’Malsina preje Kerthinjet mjen’Pleqnin t’jetasne”, 1908; “Doke Dasmash në Kanu të maleve”, 1910-1911; “Kangë darsmash”, 1910-1911;

“Vajtores”, 1906-1926; “Përralla populli”, 1900-1903; “Pirroja dhe përpjekja e tij me romakë” (punim historik) “Jeta e Skanderbegut”; “Buzmi bujar”, 1900-1926 (1927); “Kulshedra e Arbnis - Gjergj Kastriotit Krutani” (punim historik); “Ushtria kombëtare në Rubik”, 1921; “Lufta e Bregut të Matës” (përshkrim historik); “Përshkrim gjeografik i katunit Laç”, 1900; “Besimet e ndryshme”, (studim); “Usulli i gjamës burrave”; “Gjama e Dukagjinit”; “Rragami i Shalës” (përshkrim gjeografik); “Shënime i sa datave me randsi”; “Kokrra kanujet”; “Radha e mbretërve të Ilirisë”, 1926.

Përkthimet e pabotuara

“Përkthimi i Fjalëve të Urta të Sokratit”, 1921; “Ku vete?” (Quo vadis), roman i H. Sienkieviçit, 1923; “Porga fatzezë” (vepër e Ugo Foskolos) “Atil Reguli” (dramë), 19112; “Shna Nou i Padues”, 1912; “Vajza e Orleansit ose Zhana d’Ark”, 1916.

Veprat e panjohura të Gjeçovit të cilat i kam gjetur unë:

- gramatika (Zarë)

- NJË PROZË (të Nikolla Geçeviqi) në Dubravë të Zagrebit - Fotoalbumi “VESHJE DHE ARMË SHQIPTARE” (140 fotografi) në Livno, 1925,


- KRONIKA (në Livno) tash në Cetinje, të cilën ia pata dhënë Patër Vink Malajt për ta përkthyer.

Kontribuoi edhe në lëmin e arkeologjisë

Atë Shtjefën Gjeçovi dha kontributin e tij edhe në lëmin e arkeologjisë. Ky arriti të mblidhte e radhiste materiale arkeologjike, duke krijuar kështu një koleksion të pasur arkeologjik në muzeumin françeskan të Shkodrës.

Në lëmin e arkeologjisë dallohet studimi i tij “Trashigime thrako-iliriane” që botohej në revistën “Populli”, e më vonë edhe në “Hylli i Dritës”.

Shumica e veprave të tij i mbetën në dorëshkrim - të pabotuara. Por pa dyshim vepra më



e rëndësishme e Atë Shtjefën Gjeçovit është përmbledhja e rregullave të së drejtës zakonore dhe dokeve të popullit “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, vepër kjo që u botua pas vdekjes së Gjeçovit, pra u botua në S h k o d ë r n ë v i t i n 1933. Gjeçovi i kishte bërë hapat e parë edhe të speologjisë shqiptare. Kështu, ai në vitin 1923 kishte hyrë në Shpellën e Gajtanit, që deri atëherë askush nuk kishte zbritur në te. Këtë e dëshmon e dhëna se në vitin 1962 institucionet e kulturës së kohës në Shqipëri kishin përgatitur ekipin e speleologëve për të zbritur, siç thonin ata për herë të parë në Shpellën e Gajtanit. Dhe, me të mbërri ekipi i speleologëve, kishin hyrë në Shpellë dhe pasi depërtojnë diku rreth 30-40 metra në thellësi, e shohin të gdhendur në në rras guri “Shtjefën Gjeçovi, 1923”, që do të thotë se ai kishte zbritur në Shpellën e Gajtanit 33 vjet më herët. Ndërmjet shkrimeve të shumta kushtuar Atë Gjeçovit, monografinë që e kishte shkruar Rrok Zojzi, të cilën pushteti i kohës nuk ia botoi, por dorëshkrimin e Rrokut ia dhanë Ruzhi Matës, që e botoi në vitin 1983. Megjithatë unë e Skënder Zogaj e kemi botuar në vitin 1980 monografinë modeste me titull “Njeriu i penës

dhe i armës”, që do të thotë tri vjet para monografisë që u botua në Shqipëri. Do përmendur se tash e 43 vjet me radhë në zymjanët e organizojmë manifestimin letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”, që nga viti 1971, pastaj unë me shumë veprimtarë të Prishtinës dhe të Janjevës që nga viti 1996, përkatësisht nga viti 2000, e organizojmë manifestimin “Gjurmë të Gjeçovit”. Megjithatë, për Gjeçovin zymjanët kanë bërë edhe më shumë: Këtu në vitin 1968 është pagëzuar shkolla fillore me emrin e tij, këtu tash e 43 vjet vepron Klubi letrar, përkatësisht Shoqata e Shkrimtarëve “Shtjefën Gjeçovi”, që deri më tash ka botuar mbi 50 vepra letrare e monografike kushtuar Gjeçovit, Zymit, Hasit e më gjerë. Këtu Shtjefën Gjeçovit i është ngritur lapidari në vendin e vrasjes, por edhe Murana e varrit të tij. Këtu me djersën e zymjanëve është ngritur qendra kulturore “Shtjefën Gjeçovi”, e mbi të gjitha me propozimin tonë, kryetarja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, e ka dekorua postmortum Atë Shtjefën Gjeçovin me dekoratën “Për merita për kontribut dhënë çlirimit të Kosovës”.



Në Kukel. Një vizitë në Qendrën Muzeale “Ndre Mjeda”

Me rastin e shtëpisë muze dhe sistemimit e objekteve muzeale, Qendra ka marr formën e vet të duhur, duke u shndërruar në një vend shtegtimi, në fushën kulturore e të turizmit gjithëkombëtar

Me një ceremoni të veçantë është përuruar dje (18 tetor 2014) në Kukël Qendra Muzeale e Mjedës, një ceremoni ku mori pjesë Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro Furxhi, zëvendësministri Zef Çuni, e personazhe të tjerë të njohur të jetës politike e shoqërore. Pas përurimit, një vizitë në gjithë ambientet e kësaj qendre muzeale, ka ofruar për të pranishmit, një dimension të plotë të jetës dhe veprimtarisë së shumanshme të Ndre Mjedës. Kjo qendër muzeale është ngritur pas përpjekjeve të gjata dhe në saj të një bashkëpunimit të gjerë, ku vlen të veçohet vullneti i palëkundur i Dom Nikë Ukgjinit, një nga njerëzit më pasionantë dhe idetator i gjithë kësaj qendre muzeale.

Pas vizitës në Kishë të pranishmit kanë ndjekur edhe një aktivitet të veçantë nga artizanët e zonave përreth, të demonstruar në mjediset e kompleksit Mjeda. Por si u ngrit kjo qendër? Kush qenë mbështetësit e kësaj ideje? Cila është historia e ndërtimit të këtyre ambienteve, në të cilat gjendet një pjesë e shpirtit të Ndre Mjedës? Në fjalën e tij të mbajtur gjatë ceremonisë së përurimit, Dom Nikë Ukgjini zbuloi përgjigje për të gjithë këto pyetje. Më poshtë e sjellim të plotë fjalën e tij.

Puna ndërtimore e cila gjendet para jush e zhvilluar në etape të ndryshme kohore, është fryt i disa aktorëve, të heshtur apo të zëshëm, nga jashtë dhe brenda vendit tonë. Për shkak të rëndësisë që ka Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”, emrat e tyre të merituar janë të vulosur tashme në librin, me të ri Mjedologji. Dhe fal punës së bërë, jemi bashkuar në këtë festë inaugurimin. Prandaj, përshëndes në emrin tim dhe Aqripeshkvit të Shkodrës, Angelo Massafra, mysafiret që na nderuan me praninë e tyre, Kryetarin e Komunës, Zef Hila; Ministren e Kulturës, Mirela Kumbaro me stafin, autoritetet e qeverisjes; Kryetarin e Qarkut, Maxhid Cungu; diplomatin, Ambasadorin e OSB-es, dhe mikun e përherëshëm të Qendrës, Florian Raunig; Konsullin e Nderit të Austrisë, Gjergj Leqejza; Konsullin e Nderit të Italisë; Vito Stiliani; përfaqësuesit e Programit për



Zhvillim Rajonal; studiues, nga Shkodra e Tirana e shumë të tjerë. Përshëndesë në veçanti, mjedologun e madh, mikun e ngushtë të kësaj Qendre, të ndierin Mentor Quku, i cili nga lartësitë qiellore, shpirtërisht është i pranishëm në gëzimin e kësaj dite.

Miq të nderuar, Kisha dhe shtëpia ndërtuar nga dora e vet poetit, financuar nga Perandoria Austro-Hungareze, përgjatë kohës qëndrimit të tij për 30 vite me radhë, si famullitar dhe intelektual i spikatur, pati një rol të rëndësishëm në fushën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gazetari austriak, Paul Ziebertz, kryeredaktor i gazetës *Vaterland*, me rastin e vizitës së tij në Kukël, në vitin 1909, në librin e tij, *Albanie und Albanofen*, nder të tjera do shprehej se “me një bardhësi ndriçuese rrëze shpatit të malit, spikaste shtëpia e porsandërtuar e Dom Mjedës ...Ndreu, kishte ndërtuar kambanoren në mes të Kishës, - kapel dhe shtëpisë, vendosur në dy pemë të mëdha...Drita e diellit në mëngjes nuk na zgjoi, por zëri i kambanës e kalibrit të lehtë, por me një melodi e me një ton shumë të bukur e të larmishëm..”Nga goja e Ndre Mjedës mësova shume çka për historinë dhe kulturën shqiptare. Mesazhe të ngjashme kanë dhënë dhe shume studiues dhe miq të Mjedës, si, Petersen, Jokli, Majer e tjerë.

Ndre Mjeda në rrafshin kombëtar, me punën e tij brilante, ishte njëri nga më të shquarit që hyri në platformën e Rilindjes Kombëtare. Ai, derisa ishte tek Shoqëria Jezuite nguli këmbë të kthehej në atdhe e të punonte për lirin, përparimin e lulëzimin e

atdheut. Ai njihet për atdhetarizmin e zjarrtë, si edhe për përfaqësimin me dinjitet të vendit tone në kongrese ndërkombëtare, para shkencëtarëve e albanologëve, si edhe para rretheve diplomatike të huaja. E gjithë poezia e tij, si: *“Gjuha shqipe”, “Malli për Atdhe”, “Shtegtari”, “Lissus”, “Shkodra”, Liria “Vaj i Bybylit” “Vllavrasi” etj.* ku në pjesën me të madhe e shkruar dhe e rishkruar në këtë shtëpi dhe tryezën e restauruar, pati si temë kryesore çështjen atdhetare, çlirimin e atdheut, dashurinë dhe mallin për atdhe. E gjithë vepra e tij shkencore, letrare, gjuhësore, politike, artistike, qytetare, e krijuar po në këtë shtëpi, që në shërbim të kombit, atdheut dhe besimit në Zot si një vlerë universale për të cilën kishte nevojë shqiptari.

Mjeda si anëtar i Komisionit të Alfabetit në vitin 1908, njihet si personaliteti që shpëtoi punimet e Kongresit nga dështimi i plotë, përmes aktit të tij të famshëm të tërheqjes së alfabetit të vet për të cilin kishte punuar 20 vite dhe të marrjes përsipër në këtë Kongres të bashkimit të shqiptarëve detyrë që e kreu me sukses.

Mjeda, po në këtë shtëpi natën e 1-2 nëntorit 1912, përjeton një nga çastet më të vështira të jetës së tij. Perandoria osmane e arrestoj dhe i a dogji shtëpinë dhe gjitha dorëshkrimet tij. Po njëjta gjë i ndodhi edhe në vitin 1915, kur serbet e malazezet, ishin duke u tërhequr nga Shqipëria.

Dua t'i kujtoj Parlamentit shqiptar se Mjeda qe deputet në dy legjislatura të Parlamentit Shqiptar (1921-24). Qe kryetar i disa komisioneve parlamentare: të Bujqësisë, të Arsimit, të Arkeologjisë, e tjera. Qe Anëtar i Komisionit të zgjerimit të Statutit, hartues i shumë akteve të rëndësishme juridike të këtij parlamenti.

Ishte vera e korrikut 1937, kur ai në kulmin e krijimtarisë së tij shkencore e pedagogjike po merrej me transkriptimin e botimit të Pjetër Budit, si edhe me Fjalorin leksikografik të gjuhës shqipe. Pikërisht në ditët e fundit të korrikut ai bëri një vizitë të paparashikuar në Tiranë. Shkoi në parlament të takonte deputetët me të cilët kishte bashkëpunuar, por më kot: ia mbyllën derën. Mjeda, vdiq më 1 gusht 1937, pra vetëm pak ditë para se të festohej jubileu i 25-vjetorit të Pavarësisë. A ishte një vdekje e çastit apo vdiq nga malli dhe mërzia që Shqipëria nuk arriti të zhvillohej si një shtet i mirëfilltë dhe evropian, për cilën kauzë Mjeda punoj tërë jetën.

Me mbylljen e objekteve fetare në Shqipëri, në vitin 1967, Kisha qe shndërruar në depo ushtarake dhe



qela në shtëpi banimi, përkatësisht gjate viteve, 1963-79, 1982-90, shtëpi muze. Objektet duke e tjetërsuar pësuan dëmtime të madhe fizike. Me ardhjen e demokracisë pati ndërhyrje të lehta restaurues, të cilat qenë jetëshkurtër. Me ardhjen time në Kukël pas një kohe përgatitje, filloi puna restauruese rrënjësore, e cila u realizua në faza të ndryshëm kohore nga viti 2011-2014, si dhe sistemimi i plotë i Qendrës, ku me se tepërmi spikat shtatorja e realizuar falas nga skulptori Sadik Spahiu. Deri tani në këtë Qendër janë zhvilluar me dhjetëra aktivitetet kulturore e shkencore, në bashkëpunim me Komunën e Bushatit dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike si dhe botimi i revistës nr.1, Mjedologji.

Miq të nderuar, me restaurimin e shtëpisë muze dhe sistemin e objekteve muzeale, Qendra ka marr formën e vet të duhur, duke u shndërruar në një vend shtegtimi. në fushën kulturore e të turizmit gjithëkombëtar. Puna e arritur është fryte e dashamirësisë, të njerëzve vullnet mirë shqiptar dhe të huaj, të cilët kontribuan në mënyra të ndryshme që të shndërrohet në realitet Ëndrra e Jetës së poetit Mjeda, njëherit dhe e imja. Mjedologu Mentor Quku, deri tani ka botuar 12 vëllime studimore për Mjedën, dhe shprehej se “po të kisha edhe një jetë, do botoja po aq vëllime të tjera për poetin Mjeda”.

Sot, nuk duhet të guxojnë asnjë Institucion apo intelektual të kërkojë falënderime sepse e kemi detyrim të punojmë për veten tonë. Nuk guxojnë as të heshtin në këtë çast, kur jemi duke përkujtuar këtë figurë të madhe, këtë poet, prozator, gjuhëtar, këtë albanolog, paleograf, estet, arkitekt, piktor, skulptor, muzikant, poliglot, politikan, filozof, teolog, e meshtar të përhshpirtëm dom Ndre Mjedën.

**Marr nga gazeta:
Shqiptarja.com, dt. 19 tetor 2014.**

Ndue Dedaj
Rreshën

“SHTËPIA E ZOTIT DHE E MIKUT”

Nuk është e tepërt të thuhet se ne i kemi treguesit tanë identitarë për të hyrë në Evropë!

“Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut”. Sot kjo shtëpi është dy herë e Juaja”, ishin fjalët e mirëseardhjes të Presidentit të Republikës, zotit Bujar Nishani, drejtuar Atit të Shenjtë të dielën e kaluar me 21 shtator. Nuk ka një formulë më unike mikpritëse se kjo mbase në të gjithë rruzullin, që siç dihet është shkëputur nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, si një copë eshtër e tij. Vetëm në këtë sentencë planetare mund të rrinë aq pranë qiellorja me tokësoren. Dhe nuk kishte si të mos e përzgjidhte këtë urti Presidenti për mikun e rrallë. Ndoshta asnjëherë kjo frazë nuk është shqiptuar më me madhështi se në ceremoninë presidenciale të pritjes së Papa Françeskut, duke tingëlluar aq bashkëkohore dhe pse është dymijëvjeçare, ku me siguri ia kanë përkthyer Shenjtërisë së Tij kumtin e saj përrallor. E, pra, është vetëm një shprehje nga korpusi madhështor i Kanunit, këtij visari që të nxjerr faqebardhë para gjithë botës, teksa me të njëjtën ngarkesë semantike janë dhe plot postulate të tjera nga e drejta jonë dokësore. Rreth njëzet vite më parë, David Bander, gazetar për Ballkanin në “New York Times”, i pati thënë në redaksinë e saj poetit Rudolf Marku, asokohe deputet, se ju shqiptarët ligjin për shtypin e keni në një fjalë të Kanunit: “lajmësi nuk bie në gjak”. Nëse në shoqërimin e Papa Françeskut do të mund të kishin qenë prelatët e shquar të historisë, njëherësh shkrimtarë kombëtarë, nga Buzuku te Zef Pllumi,

s'kishte si të mos i dëshmonin Atit të Shenjtë se ky popull kishte mundur të rronte e mbijetonte pikërisht falë kësaj vetëdije të lartë, që mikun e njëjtësonte me Zotin, ku zor të gjendet shprehje më e lartë e përnderimit, mirëkuptimit dhe e dinjitetit të njeriut. Sa mëkat bëhet nga disa shkruar të cekët, që nga mosnjohja si duhet e Kanunit (ndonjëherë dhe nga keqdashja antiveriore maksveliste) i ngjisin atij epitete dhe nofka nga më të rëndomtat.

Një frazë e përkorë që nxirret nga hiri i shekujve dhe tingëllon aq moderne në “Shën Pjetrin” shqiptar të këtij shtatori, me afro 300 mijë vetë, në praninë e mbi 1300 gazetarëve nga e gjithë bota, tregon se sa fuqi ka tradita shqiptare dhe sa mahnitëse është ajo kur përçohet në të sotmen. Nuk është e tepërt të thuhet se ne i kemi treguesit tanë identitarë për të hyrë në Evropë. Por a i kemi skeduar të gjithë ato? Apo rrimë e kapemi përditë për xhakete për ndodhitë e kundërshtitë politike të shekullit XX, ku jemi më tepër se duhet të ndjeshëm ideologjikisht, gjykues dhe paragjykues të historisë së re, të cilën nuk mund ta kemi ne në dorë për ta shkruar? Njëmbëdhjetë vite më parë në Lezhë u kremtua 300-vjetori i Kuvendit të Arbenit, nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore-kishtarë të mesjetës, por megjithatë për të marrë pjesë në atë ceremoni nuk “teproi” asnjë funksionar i lartë shtetëror nga Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës etj., pasi në psikologjinë zyrtare të



kohës ajo ishte një ngjarje thjeshtë “fetare” dhe si mund të “përzihej” shteti laik në punë fetarie? Mirëpo tani gjerat kanë filluar të ndryshojnë, lexohet më shumë histori nga zyrat, mendjet janë bërë më të hapura, elitat sado të ngadalëta e kanë ushtruar njëfarë ndikimi mbi pushtetin, ndaj nuk është rastësi që një shprehje aq “arkaike” kanunore, si kjo për Zotin dhe Mikun, vjen e zë kryet e vendit në ceremoninë më të madhe shqiptare. E për të ndenjtur dhe pak te Kuvendi i Arbërit, mbajtur në Mërçi të Lezhës me 1703, jo rastësisht e sollëm në këtë kontekst, po se ai që e inicioi ishte një papë shqiptar, Klementi XI, i vetmi i tillë me emër dhe mbiemër, me origjinë dhe vokacion. Mjafton të shqyrtosh tekstin e atij Kuvendi për të kuptuar valencën që ai pati për gjuhën shqipe, shkollat e para dioqezane shqiptare (veçmas të Velës e Kurbinit), përballjen e fortë kulturore për mos-asimilimin otoman të shqiptarëve, thënë ndryshe, Rilindjen kombëtare, që mbase nuk do të vinte e pëlleshme pa kulme të tilla paraardhëse. Do të vijë koha që ai Kuvend emblematic do të dalë nga suaza ipeshkvnore e do të flitet për të në rang qeveritar, nga Akademia e Shkencave, universitetet etj., dhe atëherë nuk do të jetë një ngjarje “fetare” lokale, rajonale, por gjithëshqiptare, duke qenë njëherësh dhe fetare - po pse duhet të presim gjithnjë një kohë të ardhshme për të bërë atë që mundemi sot?

Vetëm nëse do të dijmë të vlerësojmë çdo fjalë të vjetër e të urtë shqipe, çdo pergamenë, amforë, kodik, hartë, mbishkrim, kala, tempull, kuvend të së shkuarës, atëherë do të mund të rilevojmë identitetin tonë kombëtar në gjithë shtrirjen dhe larminë e tij. U ndalëm në një frazë të Kanunit, me 4-5 fjalë, si nyje gjuhësore semantike i një trashëgimie të tërë dokësore, që u shqiptua nga Presidenti i vendit në një ditë të pazakontë; por atë ditë ishin aty dhe portretet e 40 martirëve të kishës, dëshmi e një martirizimi të pa shembull të hershëm e të vonë, me dhjetë a njëzetfishtin e atyre emrave, që nis me zhvarrosjen e Pjetër Bogdanit në Prishtinë, për të mos lënë të prehej as kufoma e tij. Kësisoj ai nuk është vetëm një nga shkrimtarët e parë, por dhe një nga martirët e parë shqiptar. Por deri te afishimi i merituar në zemër të kryeqytetit para një jave i kalorësve të martirizuar të krishterimit, jo të gjithë e dinin se prej vitesh kishte vazhduar procesi i kanonizimit të tyre për martirë e një ditë Vatikani do t'i shpallë si të tillë. Nëse do të publikoheshin qoftë dhe vetëm diplomat e tyre universitare të marra në Perëndim, apo ligjëratat e mbajtura ndër shqiptarë, do të kuptohej dhe më mirë



përpjekja e tyre për ta kthyer rrjedhën kulturore të Shqipërisë andej nga ajo kishte qenë qysh nga fillimet e deri në epokën e Skënderbeut.

“Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e Mikut”, e shqiptuar në një ditë të shenjtë të historisë sonë të re, do të thotë se më në fund ka një qasje të re të institucioneve shtetërore ndaj kulturës unitare dhe identitare shqiptare, që i kapërcen skemat e vjetra ideologjike dhe klishtë akademike gjithë kufizime ideore të shekullit XX. Shqipëria edhe në ligjërimin publik ka ndërruar faqe. Dikur shprehja e famshme e sipërthënë përdorej për kullën malësore, që ishte dhe një fortesë mbrojtëse nga pushtimet e huaja, kurse tash është vetë Shqipëria një shtëpi e Zotit dhe e mikut, jo vetëm me 21 shtator në pritjen e Papës, por gjithëherë. Shqipëria është një shtëpi e Evropës, me njerëz me mendësi e sjellje evropiane, pavarësisht besimit që ata kanë, katolikë, ortodoksë, myslimanë etj. “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa” ishte kredoja shqiptare e viteve '90, kur po përmysej sistemi i vjetër e po lindte i ri. Por vërtet që u vonuam shumë për të qenë pjesë e integruar e kontinentit amë, nga i cili na pati larguar historia e pamëshirshme pesëshekullore otomane dhe ajo ideologjike sovjetike më pas. Dhe kur themi shtëpia e Zotit dhe e mikut, kuptimi i parë i saj është ai i harmonisë brenda vetë shtëpisë. Nuk mund të ishte shtëpi bujare për mikun, nëse nuk ishte e fisme në radhë të parë për njerëzit e saj. Kush e njeh historinë e familjeve të mëdha shqiptare, e di se ato funksiononin si një shtet i vogël, ku anëtarët e familjes kishin mirëkuptim të padiskutueshëm mes tyre, dhe pse nuk mendonin e besonin të gjithë njësoj. Lë të jetë, pra, Shqipëria, jo vetëm shtëpi për miqtë e mëdhenj a të vegjël që vijnë nga jashtë kohë pas kohe, por miqësore për vetë shqiptarët, sidomos ata të politikës, të cilët ndonjëherë e përcjellin inatin e brendshëm deri në Bruksel e OKB.

Ben Andoni
Tiranë

KAINI DHE ABELI

Jeffrey Archer, “Keini dhe Abeli”, OMBRA GVG, Tiranë 2014.

E bukur zgjidhja e shkrimtarit britanik Archer me titullin: **“Keini dhe Abeli”**. Në fakt, s'ka lidhje fare me pjesën bazike të Biblës. Nuk janë dy vëllezërit biblikë, por dy njerëz të zakonshëm ardhur nga pika të ndryshme të Globit, të bashkuar në SHBA. Ngjarjet rrokin kohën që para Luftës së Parë dhe deri pas Luftës së Dytë Botërore, e dy personazhet tona përpiqen me mish e me shpirt t'i mbijetojnë kapitalizmit dhe t'i venë njëri-tjetrit bërryla. Andej nga fundi s'janë më bërryla, por gracka t'vërteta jete. Kapitalizëm i mirëfilli. Një anatomi e sistemit të sotëm ekonomiko-shoqëror. Fjala është për romanin e Jeffrey Archer, të titulluar “Keini dhe Abeli”, botuar së fundmi prej OMBRA GVG.


Libri 'të tmerron' me sasinë e pafundme të faqeve, por në fund të fundit, e kupton se shumë shpejt ia del. Aksioni është shumë aktiv. Rrëfimi i bërë në vetën e tretë është i këndshëm dhe shkrimtari ndërthur bukur jetët paralele, që bashkohen vetëm në pak drejtime. Nuk 'i merret' haku askujt dhe duket se edhe kapitujt janë të njëjtë si madhësi për të dy personazhet tona. Ankthi i fikshënit të shoqëron deri në fund. Kur do të bashkohen vallë dy personazhet tona?-e bën shpesh si pyetje.

Fatet jetësore të tyre s'janë kurrsesi të njëjlojtë. Abeli, që vjen nga Lindja dhe përshkon një aventurë që do t'ia kishte zili gjithkush, e Keini që ka jetë më të paqte dhe me gjërat e përcaktuara që para se të lindë. Abeli, i lindur jetim, me një ndërthurje rastesh, do zerë me vështirësi vendin, që i ka dedikuar autori; kurse Keini e ka rrugën e shtruar, njësoj si i ati dhe i gjyshi. Jeta e të dyve është një paralele, e cila tregon pamëshirën në kapitalizëm për të arritur qëllimin me çdo kusht. Të dy nuk të falin. Në majë të piramidës shkohet me luftë dhe duke shkelur. Dhe, personazhet tona e bëjnë këtë rregullisht. Pugen vetëm një herë, kur



duan të afrohen në biznes, një herë tjetër indirekt në Luftë dhe që andej e tutje nuk do bashkohen më. Në fund, kur janë afër bashkimit të vërtetë, sërish konfuzojnë, anipse është fundi edhe pse të dy nuk e pranojnë realitetin. Rrëfimtari është i baraslarguar nga dy personazhet kryesore dhe kadencën e veprës e ndjen disi 'të cënuar' në fund. Mbaron më “shpejt” sesa duhet!

Autori ka njo-huri shumë të mira të kontinen-tit, ku i jep vet-vetes të drejtën dhe të përshkru-ajë mjedise, por s'është aspak i tillë në mjedisin amerikan, ku zhvillohet pjesa tjetër më e madhe veprës. Grinaja e veprës të ndjek kudo në mjedisin amerikan, kurse dashuria për kontinentin është evidente me ngjyrat më të gjalla dhe lirismin e pakët. Libri ka kufizimet e veta, por i ka rezistuar kohës, pasi duhet të kujtojmë se është botuar plot 35 vjet më parë. Aksioni të ndjek në çdo kapitull, që ka kundërpartin reciprok me kapitullin e personazhit tjetër. Libri, madje, me pak kompozicion ndryshe, mund të ishte efikas sikur edhe të ishte me vetëm



një nga personazhet.

Megjithatë me kohët e reja, autori mund ta ruante këtë roman koral dhe po të kishte më shumë vizion imazhi, me fare pak elementë, mund ta lehtësonte lexuesin prej të gjithë kësaj ndërmarrje leximi.

Nga ana tjetër, të kënaq fakti sesa bukur e njihet anatominë e të keqes, Jeffrey. Dhe, fakti që Autori do përfundojë edhe vetë realisht në burg kohë më vonë, e bën shumë më interesant në të gjithë zhvillimin e vet romanin.

Edhe njëherë për personazhet: Abeli, që vjen nga Polonia prej një familje të varfër, por që historia e lidh indirekt me një familje shumë të pasur, është fryma e vërtetë e përpjekjes humane në roman. Ai kalon të gjithë peripecitë që mund të kalojë një qenie e gjallë, derisa përfundon në Botën e Lirë. Aftësitë e veta e bëjnë t'i përdorë me efikasitet të gjitha rrethanat dhe shtuar edhe me fatin që e ndjek kudo, ai njihet vetëm suksese. Edhe pse suksesin, ai e di se ka çmimin e vet. Ai sakrifikon. Ai jep ryshfet. Ai shkel. Manovron. Ai shkon madje edhe ushtar në nderim të kombit të vet të ri, por për shpirtin e kombit t'vet të pushtuar.

Keini, nga ana tjetër, që ka lindur në të njëjtën ditë, e ka më të shtruar jetën, por edhe suksesin. E di që edhe jeta e vet ka kushtet e përcaktuara. Edhe ai shkon ushtar dhe madje edhe plagoset. Një episod e lidh me armikun e vet mu në fushën armike dhe përshkruhet si idil. Abeli është human me mikun e vet. Pa e ditur. Është për t'u sqaruar se autori është shumë më i dhënë pas shtresave të larta, që u fal të gjithë penelatat e duhura. Sa i përket shtresës së varfër, ka një lloj 'përbuzje' në të gjithë veprën për ta. Edhe këtu është një justifikim. Personazhet e veta janë dy manjatë të fuqishëm. Njëri bankier dhe tjetri pronar restorantesh që pak u bën përshtypje për gjërat e tjera. Historia është se të dy luftohen, pa ditur se në një moment do jenë fëmijët brezi më pragmatik dhe më idealist, që e prishin këtë ego të frikshme. Vajza e Abelit është e dashuruar me të birin e Keinit dhe të dy nuk e dinë fillimisht se janë aq të pasur. U pëlqen të jenë të përkorë, vetëm që ta ruajnë dashurinë. Një nga idilet e autorit, që shpejt e kupton se është pak e tepruar. Në momentin kur dy të rinjtë mundësojnë vite më vonë që prindërit të takohen, pleqtë "gërnjarë" mbarojnë njëri pas tjetrit. Zhvillimi njerëzor ka logjikën e vet dhe nuk i pranon shumë idilet... Përkthyesit kanë punuar mirë, por dy përkthyes në një vepër e prishin pak zemrekun, megjithatë të dy përkthyesit tanë e kanë mbajtur disi tempin e tyre.



Dorian Koçi
Tiranë

RRUGËTIMI I IDENTITETIT FETAR

Ka një farë afiksacioni të shqiptarve në ditët e sotme me pragmatizmin e skajshëm të “evropianizimit” të jetesës së tyre, ku dhe identiteti fetar tashmë i paracaktuar sipas disave, përderisa rrojmë në Evropë duhet të ketë një tendence kristianizmi ose në qoftë se jo e tillë, të “paktën semi-kristian” siç e përcaktonte Konica në prag të shpalljes së pavarësisë.

Ekzistenca e shtetit shqiptar të vitit 13' e në vazhdim do përbente një kuriozitet të veçantë sociologjik për të gjithë ata që do ta ndiqnin nga afër, pasi kërkohej të kryhej pothuajse e pamundura, të ngrihej dhe mbijetonte një shtet me fqinjë agresivë që nuk dëshironin që ta njihnin pasi tokat shqiptare i konsideronin si plaçka të luftës ballkanike që kishin fituar, me rezerva financiare të pamjaftueshme as për të paguar rrogat e nëpunësve të vet dhe me një popullsi që ishte në mes të formimit të identitetit kombëtar dhe e ndarë në katër besime fetare. Nga të gjitha vështirësitë, kjo e fundit paraqiste pengesën më të madhe pasi identiteti fetar dhe bashkimi fetar ka qenë një nga qelizat më të forta të shoqërive, që kanë aspiruar dhe janë krijuar si kombe. Në vende të ndryshme këto tipare vazhdojnë ende të jenë përcaktues për zgjedhje të ndryshme apo hartimin e politikave të ndryshme. Në Shqipëri për shkak të ekzistencës së tre besimeve fetare, identiteti fetar u mënjanua nga zgjimi nacionalist i tyre, duke ia lënë rrugën kulturës dhe gjuhës kombëtare. Në këtë rrugë të pashkelur nga asnjë nga fqinjët e vet ballkanikë, shqiptarët filluan sprovën e tyre për të ndërtuar shtetin e tyre, sprovë që pas etheve të para vetshkatërruese të bazuara mbi identitetet fetare,

si lëvizja e Haxhi Qamilit, lëvizja “epiriotase” e Zografos dhe republika e “vetëshpallur” e Mirditës nga Marka Gjoni, përgjithësisht ka dalë me sukses, duke u bërë kështu një ilustrim i teorisë së dështuar të historicizmit dhe një rrugë moderne përsa i përket marrëdhënieve të shtetit me religjionin.

Analiza tradicionale të marrëdhënieve midis shteteve dhe besimeve fetare tregojnë se ka tre modele të tilla. Modeli i parë është sistemi i bazuar në marrëveshje midis shtetit dhe besimeve fetare, modeli i dytë është sistemi i karakterizuar nga ekzistenca e kishës shtetërore apo nacionale dhe sistemi i tretë, i cili ka një ndarje të qartë midis shtetit dhe besimeve fetare. Modeli i tretë i cili quhet dhe secular apo laik dhe është modeli të cilin ka marrë për bazë shteti shqiptar për të ndërtuar marrëdhëniet e veta me komunitetet fetare. A është kjo zgjedhje, një prirje moderniste e shqiptarëve apo është një zgjedhje e detyruar për shkak të identiteteve të ndryshëm fetarë që është e përbërë Shqipëria? Natyrisht përgjigje nuk mund të jepet lehtë, veçanërisht nëse krahason aspekte të tjera të jetës dhe kulturës sonë për të parë nëse ato kanë qenë kaq moderne sa prirja e shqiptarëve përkundrejt besimit fetar në këto 85 vjet të shteti të stabilizuar





shqiptar. Por edhe në qoftë se nuk është kështu, do me thënë zgjedhja në fillimet e viteve 20' ka qenë e imponuar për shkak të realiteteve fetare, askush nuk mund ta mohojë sot prirjen moderniste të identitetit fetar të shqiptarëve.

Kjo prirje është e lidhur shumë e ngushtë dhe me identitetin kombëtar kaq të përfolur në ditët tona, aq sa shpesh herë duket se në debatin Lindje-Perëndim do të përcaktohet dhe vendi i shqiptarëve në hemisferë sipas besimit të tyre fetar. Kjo lloj përjasje mendoj se është e gabuar sepse të kërkojë ti përshtatesh mjedisit (do me thënë Evropës ku jetojmë) do të thotë që ta konsiderosh veten një “patate të Lisenkos”, e cila rritet dhe fryhet por humbet shijen e vetë origjinale. Ka një farë afiksacioni të shqiptarëve në ditët e sotme me pragmatizmin e skajshëm të “evropianizimit” të jetesës së tyre, ku dhe identiteti fetar tashmë i paracaktuar sipas disave, përderisa rrojmë në Evropë duhet të ketë një tendencë kristianizmi ose në qoftë se jo e tillë, të “paktën semi-kristian” siç e përcaktonte Konica në prag të shpalljes së pavarësisë.

S'ka asnjë gjë të keqe nëse në momente të caktuara individë apo grupe njerëzish vendosin të përqafojnë një identitet tjetër fetar nga ai i mëparshmi, aq më tepër që kjo është e garantuar nga Karta e të Drejtave Themelore të Njeriut, artikulli 10. Por kur kjo tendencë shkon dhe në përqaftimin e një identiteti kombëtar tjetër atëherë këtu çalon diçka, dhe duhet të fillojmë të dyshojmë nëse zgjedhja është bërë sipas kërkesës shpirtërore të pa përmbushur nga besimi i mëparshëm apo thjesht pragmatizëm në

përfitim të një statusi të qytetarit të hemisferës perëndimore? Me hemisferë perëndimore nënkuptoj Perëndimin me të tërë zhvillimin e tij social, historik kulturor, përkundrejt Lindjes të përfaqësuar nga hemisfera lindore. Shqiptarët kanë patur fatin historik (mirë apo për keq, kjo mbetet ende një pyetje e hapur) tu përkasin të dyjave influencave dhe të jenë vendi ku të dyja botët janë ndeshur ashpër. Vetëm 95 vjet më parë territori ynë konsiderohej Lindja e Afërme dhe ishim pjesë e një perandorie që shtrihej nga Eufrati deri në Ballkan, kurse 95 vjet më vonë territoret tona quhen Ballkani Perëndimor dhe jemi gati të hyjmë në njësinë më të përparuar përsa i përket sot zhvillimit kulturor, social dhe ekonomik - Bashkimin Evropian.

A do të marrim me vete ndonjë gjë nga të qënurit tonë si ex-Near Eastern apo do hyjmë si present-Balkan Western, që është afër për të mos thënë më mirë pro-european lifestyle. Përgjigjen mund ta kërkojmë ta gjejmë në diasporat shqiptare në Evropë të cilat janë integruar më shpejt sesa popullsia në Shqipëri në tërësinë administrativo-ekonomikë ku ne aspirojmë të hyjmë. Fatkeqësisht, vihet re një ri-gjallërim i identitetit fetar disa herë të trashëguar disa herë të fituar në vendin pritës, dhe që shpesh herë është i shoqëruar dhe me përqaftim të një identiteti tjetër kombëtar. Jemi ndoshta nga të paktat shtete në Evropë që mund të kemi probleme të vetëdijes kombëtare dhe të “kacafytjes” nacionaliste për të bindur njerëz tanë, bashkatdhetarë se na përkasin “neve” dhe jo “të tjerëve”. Në fakt fenomeni nuk është i ri,

pasi në asnjë komb tjetër në Evropë nuk gjendet shprehja “gjaku ynë i shprishur”. Për shekuj me radhë shqiptarët furnizuan repartet drithëruese të jeniçerëve dhe shpesh herë qindra nga ata bënë një karrierë të shkëlqyer me një identitet të ri fetar dhe identitet të ri kombëtar, por çështja shtohet nëse gabuam njëherë në mugullirat tona të historisë kur nuk ishim të ndërgjegjshëm si komb a duhet të gabojmë tani sërish në prag të festimit të njëqindvjetorit të pavarësisë?

Duke qenë njëherë viktimë të një inxhinierie sociale që na shkatërroi rëndë sepse kthimi jonë nga Njeriu i Ri i socializmit real në “homo sapiensin” normal u shoqërua me trauma, efektet e të cilave i shikojmë përditë në jetën tonë të përditshme, do të jetë shumë e vështirë që të krijojmë apo të marrim hua një identitet tjetër. Nëse ekzistenca dhe mbijetesë e shtetit shqiptar të vitit 1913 ka pushuar së qeni një eksperiment sociologjik, dhe është tashmë një realitet atëherë suksesin nuk duhet ta shikojmë në tipin e këshillave koniciane për të përqasur identitete, por në diversitetin e këtyre identiteteve.

Shoqëria e sotme shqiptare pas një rrugëtimi të gjatë të integritit të kulturave, si rezultat i identiteteve të ndryshme fetare është çka Evropa ka propaganduar dhe kërkuar të jetë shoqëria e saj në të ardhmen. Krisma e armës që vrau arkidukën Ferdinand në Sarajevë më 1914, prishi përgjithmonë dhe Bosnjën idilike të Ivo Andriçit dhe statukuo-n fallco të harmonisë midis identiteteve fetare që se ndjenin veten një komb. Fatmirësisht shqiptarët kanë zgjedhur që të ndihen si komb në fillim dhe pastaj të identifikohej si identitete fetare dhe kjo prirje moderniste e tyre ka treguar se ka qenë zgjedhja më e mirë që kanë bërë ndonjëherë. Përgjigjja proverbiale e poetit kombëtar të shqiptarëve patër Gjergj Fishtës, kur një diplomat francez e pyeti sesi ka mundësi që të besosh në mbijetesën e një shteti të tillë me tre besime? ishte: “po është e vërtetë zotëri se kemi tre besime, por ne nuk kemi pasur ndonjëherë Natë Shën Bartolemeu”, vazhdon të mbetet sfiduese edhe për kombe dhe shtete shumë më të zhvilluara sesa Shqipëria.



INAUGUROHET “SHTËPIA MUZE” E MJEDËS NË KUKËL

Në Kukël, Komuna Bushat, me 18 tetor 2014, vendin ku poeti dhe liriku Dom Ndre Mjeda, jetoj dhe punoj për 30 vite me radhë, është inauguruar “Shtëpia muze Ndre Mjeda” e restauruar kohë të fundit.

Në këtë inaugurim, fjalën përshëndetës ne emër të Arqipeshkvit të Shkodrës, Mons. Angelo Massafra, e mbajti Drejtori i Qendrës, Dom Nikë Ukgjini, i cili theksoj se “Ndre Mjeda në rrafshin kombëtar, me punën e tij brilante, ishte njëri nga më të shquarit që hyri në platformën e Rilindjes Kombëtare” dhe “me restaurimin e Shtëpisë muze dhe sistemin e objekteve muzeale, Qendra ka marr formën e




Kumbaro e cila me Zef Hilen, preu shiritin e inaugurimit, u shpreh se kjo Qendër tashme po merr formën e një qendre pelegrinazhi të vyere fal punës së pa lodhur të Dom Nikës. Ndërsa, Kryetari i Komunës, Zef Hila, foli për përkrahjen që ka dhënë komuna, për realizimin e këtyre projekteve. Me pas folën, Kryetari i Qarkut, Maxhit Cungu, Ambasadori i OSBE-ës Florian Raunig, dhe Konsulli i Nderit të Italisë, Vito Stiliani. Të pranishëm ishin dhe zv. Ministri Kulturës, Zef Çuni, Konsulli i Nderit të Austrisë, Gjergj Leçeja, studiues nga Shkodra, Tirana dhe mysafire nga Kosova.



vet të duhur, duke u shndërruar në një vend shtegtimi. në fushën kulturore e të turizmit gjithëkombëtar”. Ministria e Kulturës Mirela

Është tashmë një shtëpi muze, me dhomat e saj të mbushura me eksponate dhe me tavolinën legjendare të poetit Mjeda





Konferenca Ipeshkvnore
e Shqipërisë

1700 VJETORI I EDIKTIT TË
MILANOS

Gjergj Fishta, Lezhë 2014

Papa Françesku

GËZIMI I UNGJILLIT

Ylber, Tiranë 2014

Mentor Quku

MJEDA 2 - Proza

Ilar, Tiranë 2014

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 5/6 (464-465) Maj - Qershor 2014